FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2018 – Numri: 141

Tiranë – E mërkurë, 3 tetor 2018

PËRMBAJTJA

		Faqe
Dekret i Presidentit nr. 10886, datë 21.9.2018	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	9509
Dekret i Presidentit nr. 10887, datë 21.9.2018	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	9509
Urdhër i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 150, datë 3.4.2018	Për një ndryshim në urdhrin nr. 344, datë 19.8.2013, "Për ngritjen e Njësisë së Shërbimit Psikosocial"	9510
Urdhër i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor nr. 507, datë 26.9.2018	Për delegim kompetencash.....	9510
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, datë 10.4.2018	Për çështjen "Eglantina Bakiu dhe të tjerët kundër Shqipërisë" (kërkesa nr. 43928/13 dhe 16 kërkesa të tjera)	9511
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 60, datë 6.9.2018	Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshimin e tarifave të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Delvinë.....	9533
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 61, datë 6.9.2018	Për marrjen e masave administrative ndaj shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Dibër sh.a.....	9534

Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 62, datë 6.9.2018	Për licencimin e Ujësjellës-Kanalizime sh.a. Sarandë.....	9534
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 63, datë 6.9.2018	Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshimin e tarifave të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Lushnjë sh.a.....	9535
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 64, datë 6.9.2018	Për mosmarrjen në shqyrtim të aplikimit për miratimin e tarifave të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Fier.....	9536
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 65, datë 6.9.2018	Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Kavajë.....	9537
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 66, datë 6.9.2018	Për një ndryshim në vendimin nr. 54, datë 15.12.2017, "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Kolonjë".....	9538
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 67, datë 6.9.2018	Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Dropull.....	9538
	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), datë 26.9.2018.....	9539

DEKRET
Nr. 10886, datë 21.9.2018

PËR LEJIMIN E SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c", dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe neneve 15 e 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Mikel Sander Tirana
2. Drenica Ismajl Lataj (Malaj)
3. Elona Thoma Xani (Joxhe)
4. Denis Man Motina
5. Klintis Burhan Gakovi
6. Evis Halit Burhan Gakovi
7. Azeta Vladimir Hügel (Hoxha)
8. Andrijana (Ardiana) Savo Matanović (Mixho/Matanaj)
9. Mirjana (Ermira) Milenko Matanović (Mixho)
10. Abla Sulejman Begollari
11. Afërdita Ferhat Krilić (Çekerku)
12. Emmi Llukan Dushi
13. Edlir Rapo Nuhaj
14. Mateo Edlir Nuhaj
15. Klaus Edlir Nuhaj
16. Entela Marks Nuhaj (Hajdini)
17. Florinda Sulejman Dürkop (Koçi/Koci)
18. Alexis Bardhok Dervishaj
19. Keti Fatmir Tafaj
20. Megi Arben Dedei
21. Arjona Edmond Banaj
22. Melsi Refki Seferi
23. Juliana Dhimitër Prifti
24. Anna Melsi Seferi
25. Gloria Melsi Seferi
26. Victoria Melsi Seferi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET
Nr. 10887, datë 21.9.2018

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c", dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e Ministrisë së Brendshme, ministrit të Shtetit për Diasporën, ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Edison Nazmi Kica
2. Imri Sahit Salihu
3. Reshat Murtezan Vehapi
4. Agata Rezhep Jashari (Gashi)
5. Arian Sejdi Shala
6. Resul Ökkaş Taşkin
7. Sezai Yusuf Atay
8. Vildan Imayet Kara (Gülistan)
9. Agon Shkelzen Maliqi
10. Nurettin Haci Tilki
11. Blerand Agim Hulaj
12. Francesca Antonino Ferrara
13. Fëllanza Shaib Gjinolli (Rizvanolli)
14. Fitim Vesel Pagarusha
15. Florije Shyqri Pagarusha (Bala)
16. Rron Tarik Pagarusha
17. Blerina Ibrahim Xhemajli
18. Bajram Ramadan Hasani
19. Arbenita Naim Hasani (Drugzani)
20. Eni Besim Baraliu
21. Genc Gëzim Grezda
22. Valbona Avni Grezda (Vula)
23. Armend Zenun Xhoxhaj
24. Matvei Sergei (Sergey) Petrov
25. Diptiben Chetankumar Jayantilal Sandesara
26. Gjane Nue Morina (Milici)
27. Lendita Zef Morina
28. Valbone Zef Syla (Morina)
29. Bekim Zef Morina

30. Blerim Zef Morina
31. Jozefina Gjon Morina (Markaj)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

URDHËR
Nr. 150, datë 3.4.2018

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 344, DATË 19.8.2013, "PËR NGRITJEN E NJËSISË SË SHËRBIMIT PSIKOSOCIAL"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 20, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 175, datë 8.3.2017, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar", të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 13.9.2017, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë",

URDHËROJ:

1. Shkronja "b", e pikës 5, e urdhrit nr. 344, datë 19.8.2013, ndryshon si më poshtë: "Në institucionet e arsimit të mesëm të lartë të sigurohet një psikolog dhe një punonjës social për 1800–2300 nxënës, ndërsa për çdo institucion të arsimit të mesëm të lartë të llojit gjimnaz me mbi 700 nxënës të sigurohet një psikolog ose një punonjës social.

2. Numri i punonjësve të shërbimit psikosocial, që shtohen në zbatim të këtij urdhri, të bëhet brenda numrit të punonjësve mësimorë, të miratuar për vitin 2018, për çdo drejtori arsimore rajonale dhe zyrë arsimore".

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, njësitë arsimore vendore.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Lindita Nikolla

URDHËR
Nr. 507, datë 26.9.2018

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; të shkronjës "r", të nenit 10, të vendimit nr. 124, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e statutit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; të kapitullit 3.2, shkronja "A", pikat 3 dhe 4, të rregullores së përgjithshme, "Për funksionimin e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor",

URDHËROJ:

1. Delegimin e firmës së titullarit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, znj. Anila Minxhozi, me detyrë zëvendësdrejtor i përgjithshëm, të nënshkruajë çdo shkresë që del nga institucioni, në mungesë dhe me porosi të drejtorit të përgjithshëm të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, për shkak të mungesës me arsye të titullarit të këtij institucioni, për periudhën nga data 27.9.2018 deri në datën 5.10.2018.

2. Për veprimet e kryera në zbatim të këtij urdhri zëvendësdrejtori i përgjithshëm do të ruajë kopje të kartelave shoqëruese të praktikave shkresore, të iniciuara apo të përfunduara prej tij, së bashku me afatet e përcaktuara dhe ecurinë e mbarëvajtjen e çështjeve dhe do t'ia bëjë të ditura titullarit me rikthimin e tij në detyrë.

3. Nuk delegohen kompetencat e titullarit lidhur me personelin, si dhe kompetencat e tjera të padelegueshme, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet znj. Anila Minxhozi, zëvendësdrejtor i përgjithshëm.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM
Anila Denaj

SEKSIONI I DYTË
VENDIM
Kërkesa nr. 43928/13
Eglantina BAKIU dhe të tjerët kundër Shqipërisë dhe 16 kërkesa të tjera
(shih listën bashkëngjitur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Dytë), e mbledhur më 10 prill 2018, si një Dhomë, e përbërë nga:
Robet Spanno, *kryetar,*
Paul Lemmens,
Ledi Bianku,
Nebojša Vučinić,
Valeriu Griţco,
Jon Fridrik Kjølbro,
Stéphanie Mourou-Vikström, *gjyqtarë,*
dhe Stanley Naismith, *regjistrar i Seksionit,*

Duke pasur parasysh kërkesat e mësipërme të listuara në tabelën bashkëngjitur dhe të paraqitura në data të ndryshme, të cilat jepen në vijim,

Duke pasur parasysh vërejtjet e paraqitura nga Qeveria e paditur, si edhe vërejtjet e paraqitura nga kërkuesit si përgjigje ndaj të parave,

Pasi ka diskutuar, vendos si më poshtë:

FAKTET

1. Çështja filloi më 30 prill 2013 me shtatëmbëdhjetë kërkesa (43928/13, 43934/13, 44107/13, 44132/13, 44136/13, 44140/13, 44147/13, 44150/13, 44152/13, 44153/13, 44522/13, 44526/13, 44535/13, 44542/13, 44548/13, 44611/13 dhe 44632/13) kundër Republikës së Shqipërisë, paraqitur në Gjykatë mbështetur në nenin 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa"), nga tridhjetë e pesë shtetas shqiptarë.

2. Kërkuesit u përfaqësuan nga z. D. Matlija dhe z. T. Alexandridis, dy avokatë të cilët ushtrojnë profesionin në Tiranë. Qeveria shqiptare ("Qeveria") u përfaqësua nga agjenti i saj, zj. A. Hicka, nga Avokatura e Shtetit.

A. Rrethanat e çështjes

3. Faktet e çështjes, e paraqitura nga palët, mund të përmblidhen si më poshtë.

4. Kërkuesit, detajet personale të të cilëve paraqiten në tabelën bashkëngjitur, janë shtetas shqiptarë. Ata janë grupuar sipas familjes ku bëjnë pjesë.

1. Konteksti përkatës

5. Gjatë periudhës komuniste, familjet jetonin në banesa shtetërore, mbështetur në marrëveshje qiraje. Banesat private, të cilat kaluan në pronësi të Shtetit sipas legjislacionit për shtetëzimin, iu dhanë nga qeveria komuniste familjeve të tjera, të cilat, në atë kohë, si rregull, punonin për institucionet shtetërore. Në të tilla raste, autoritetet vendore lëshonin autorizime për zënien e banesës, të cilat kishin fuqinë të garantonin të drejtën për qiramarrjen e një apartamenti ("qiramarrje e sigurt"). Marrëveshja e qiramarrjes së sigurt lidhej midis qiramarrësve dhe Ndërmarrjes Komunale për Strehimin në Banesat Shtetërore (Ndërmarrja e Strehimit).

6. Në vitin 1992, pas rënies së regjimit komunist, akti për privatizimin e banesave shtetërore parashikonte privatizimin e të gjitha banesave shtetërore në interes të familjeve që i kishin zënë ato. Nuk ekzistonte asnjë dispozitë për privatizimin e banesave private, të cilat ishin shtetëzuar dhe ishin zënë nga qiramarrësit (shih më poshtë "Akti për privatizimin e banesave shtetërore" për informacione të detajuara).

7. Në vitin 1993, hyri në fuqi akti për rikthimin dhe kompensimin e pronave. Ish-pronarëve ose trashëgimtarëve të tyre iu dha e drejta të kërkonin rikthimin e pronave të shpronësuara ose të shtetëzuara, si edhe kompensim. Rikthimi i banesave të zëna nga qiramarrësit nuk kishte ndikim mbi marrëveshjet e qiramarrjes së sigurt, tashmë e finalizuar, e cila mbetej nën kontrollin e ligjit (shih më poshtë seksionin mbi "Akti i pronave 1993" për informacion të detajuar).

8. Në vitin 2004 dhe 2006, legjislatura nxori një afat kohor brenda të cilit qiramarrësit duhej të lironin banesat, të cilat i ishin rikthyer ish-pronarëve. Dispozitat e sipërpërmendura u rrëzuan nga Gjykata Kushtetuese në vitin 2005 dhe 2007, respektivisht (shih më poshtë vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 26/05 dhe 11/07 për informacione të detajuara).

2. Rrethanat e kërkesave

9. Kërkuesit jetonin si qiramarrës prej shumë vitesh (prej njëzet e një deri në gjashtëdhjetë e shtatë vjet) në njësitë e banimit, të cilat pas rënies së komunizmit iu ishin rikthyer ish-pronarëve. Kërkuesit e kishin paguar qiranë e kontrolluar nga Shteti në mbështetje të ligjit vendës (shih më poshtë "Ligji përkatës vendës").

10. Më 1 gusht 2012, Qeveria lëshoi një akt normativ me anë të të cilit urdhëronte qiramarrësit të lironin banesat, që iu ishin rikthyer ish-pronarëve ("Akti normativ 2012").

11. Më 13 shtator 2012, Parlamenti miratoi një ligj i cili mbështeste aktin normativ të vitit 2012.

12. Më 20 gusht 2012, Shoqata e Qiramarrësve në Shtëpitë Shtetërore ish-Pronë Private ("Shoqata") kundërshtoi kushtetutshmërinë e aktit normativ të vitit 2012.

13. Më 31 tetor 2012, Gjykata Kushtetuese nuk pranoi ankesën kushtetuese të Shoqatës dhe e shpalli aktin normativ të vitit 2012 kushtetues. Vendimi i arsyetuar u bë publik më 6 shkurt 2013 (shih seksionin më poshtë "Procedimet e brendshme" në "Aktin normativ të vitit 2012", për informacione të detajuara).

14. Sipas aktit normativ të vitit 2012, ndaj kërkuesve ishin lëshuar urdhra për nxjerrjen e tyre jashtë, si edhe urdhra gjyqësorë për zbatim të vendimit.

15. Më 12 dhjetor 2012, Shoqata dhe 638 qiramarrës, duke përfshirë të gjithë kërkuesit, i drejtuan një peticion Këshillit të Ministrave, ku pretendonin se akti normativ i vitit 2012 nuk parashikonte masa efikase për garantimin e banesave për ata. Më tej, ata i kërkonin autoriteteve të shtynin nxjerrjen e tyre nga banesat deri pas pushimeve të Krishtlindjeve. Në fund të letrës shkruhej: "kërkuesit, disa anëtarë të Shoqatës së Qiramarrësve në Banesat Shtetërore ish-Pronë Private". Këshilli i Ministrave nuk dha asnjë përgjigje.

16. Asnjë nga kërkuesit nuk zotëronte ndonjë pronë të paluajtshme ose ndonjë banesë tjetër alternativ në momentin kur u lëshuan urdhrat ndaj tyre për nxjerrjen jashtë dhe vendimet e gjykatës për zbatimin e urdhrave. Statusi ekonomik i kërkuesve përshkruhet shkurtimisht në shtojcën 1 në vijim.

17. Në vitin 2013 dhe 2014, Banka Kombëtare Tregtare ("Banka") (shih për më shumë informacion në seksionin më poshtë "Akti normativ 2012") lidhi marrëveshje për hua me zero interes me shtatë familje, më konkretisht Bakiu (kërkesa nr. 43928/13), Toqi (kërkesa nr. 43934/13), Kovaci (kërkesa nr. 44132/13), Ilirjan Subashi (kërkesa nr. 44153/13), Paja (kërkesa nr. 44535/15), Vladimir Dhimitri (kërkesa nr. 44611/13) dhe Kadareja (kërkesa nr. 44632/13), respektivisht më 11 shtator 2013, 28 qershor 2013, 20 mars 2013, 2 gusht 2013, 25 mars 2014, 24 qershor 2013 dhe 23 maj 2013, për disbursimin e huave me shumat prej 37,000 euro (EUR), 40,700 euro; 28,260 euro; 31,500 euro; 25,440 euro; 40,700 euro; dhe 18,000 euro, respektivisht.

18. Kërkesat për huan me interes zero të paraqitura nga familjet Batku (kërkesa nr. 44107/13), Xhillari (kërkesa nr. 44147/13), Vincani (kërkesa nr. 44150/13), Spahiu (kërkesa nr. 44522/13) dhe Fikaj (kërkesa nr. 44548/13) u refuzuan nga Banka me arsyetimin se nuk përmbushnin kërkesat e saj për marrjen e një huaje.

19. Familjet Reci (kërkesa nr. 44526/13) dhe Lulzim Dhimitri (kërkesa nr. 44542/13) u klasifikuan si "të pastrehë", por nuk mundën të plotësonin dokumentacionin e nevojshëm për marrjen e një huaje. Autoritet nuk patën informacione të tjera në lidhje me tri familjet e tjera, më konkretisht Meta (kërkesa nr. 44136/13), Nikolla (kërkesa nr. 44140/13) dhe Bujar Subashi (kërkesa nr. 44152/13).

3. Situatat individuale të kërkuesve

20. Duke qenë se në dosje mungonin informacione në lidhje me situatat individuale të kërkuesve në kohën e komunikimit e çështjes Qeverisë, Gjykata i kërkoi kërkuesve të paraqisnin informacione faktike për sa i përket: përmasës së banesës, vlerës së përllogaritur të banesës, vendndodhjes së banesës, qirasë mujore të paguar, qirasë mesatare mujore dhe fitimeve të tyre mujore. Në vijim, atyre iu kërkua të informonin Gjykatën nëse ishin zbatuar urdhrat për nxjerrjen nga banesa. Gjithashtu, atyre iu kërkua të jepnin informacion në lidhje me situatën e tyre të strehimit në atë kohë dhe për mënyrën se si ata synonin të gjenin akomodim afatgjatë.

21. Vetëm disa prej kërkuesve u përgjigjën me shkrim, duke dhënë disa nga informacionet e kërkuara nga Gjykata. Informacionet e detajuara gjenden në shtojcën 2 në vijim.

Në përgjigje të pyetjes së Gjykatës nëse ishin zbatuar urdhrat për nxjerrjen nga banesa, vetëm familjet Bakiu (kërkesa nr. 43928/13), Reci (kërkesa nr. 44526/13) dhe Paja (kërkesa nr. 44535/13) paraqitën dokumente të përmbarimit,

sipas së cilave dy familjet e para ishin nxjerrë nga banesat më 30 janar 2013, ndërsa familja Paja ishte nxjerrë më 12 shkurt 2013. Kërkuesit e tjerë nuk paraqitën dokumente të përmbarimit të cilat tregonin datën e saktë të nxjerrjes së tyre nga godina.

Ankuesit paraqitën në Gjykatë, midis të tjerash, si më poshtë:

Kërkuesit që i përkisnin familjes Bakiu (kërkesa nr. 43928/13) parashtruan se ishte marrë një hua me 0% interes nga mbesa e tyre, e cila nuk ishte anëtare e familjes, duke qenë se nuk ishin përmbushur kërkesat e Bankës për marrjen e një huaje. Në vijim, ata kishin blerë një apartament, ku edhe jetonin në kohën e parashtrimit.

Kërkuesit që i përkisnin familjes Bujar Subashi (kërkesa nr. 44152/13) parashtruan se ishte marrë një hua me 0% interes, por ata nuk kishin mundur ta përdornin atë. Në vend të kësaj, disa nga anëtarët e familjes kishin marrë me qira një apartament; anëtarët e tjerë u strehuan nga të afërmit e tyre.

Kërkuesit, të cilët i përkisnin familjes Ilirjan Subashi (kërkesa nr. 44153/13) kishin marrë një hua me 3% interes nga Bashkia e Tiranës. Duke qenë se huaja nuk ishte e mjaftueshme, ata ishin të detyruar të kërkonin ndihmën e një personi tjetër për të marrë një hua tjetër nga banka. Rezultoi se kërkuesit blenë një apartament, ku edhe jetonin gjatë kohës së parashtrimit.

Kërkuesi z. Reci (kërkesa nr. 44526/13) kishte marrë me qira një apartament dhe e kishte të pamundur të merrte një hua nga Banka, sepse nuk përmbushte kërkesat përkatëse.

Kërkueses Paja (kërkesa nr. 44535/13) iu dha një hua me 0% interes. Rezultoi se ajo kishte blerë një apartament, ku edhe po jetonte gjatë kohës së parashtrimit.

Kërkuesit, të cilët i përkisnin familjes Lulzim Dhimitri (kërkesa nr. 44542/13) kishin marrë me qira një apartament në kohën e parashtrimit, sepse ata nuk përmbushnin kërkesat e Bankës për të marrë një hua.

Kërkuesit, të cilët i përkisnin familjes Fikaj (kërkesa nr. 44548/13) kishin marrë një apartament me qira në kohën e parashtrimit. Kërkesat e tyre për një hua me interes 0% dhe strehim social ishin rrëzuar nga autoritetet, sepse nuk kishin përmbushur kërkesat përkatëse.

Kërkuesit, të cilët i përkisnin familjes Kadareja (kërkesa nr. 44632/13) kishin marrë një hua me 0% interes. Në vijim, ata kishin blerë një apartament, ku edhe jetonin gjatë kohës së parashtrimit.

22. Kërkuesit e tjerë informuan përfaqësuesit e tyre ligjorë se ishin strehuar nga të afërmit, shpesh në shtëpi ku ishin shumë ngushtë. Ata u shprehën se për shkak të varfërisë, nuk kishin mundësi të siguronin strehim alternativ për veten dhe familjet e tyre, përveç garantimit të strehimit social.

B. Ligji dhe praktika përkatëse vendëse

1. Kushtetuta e Shqipërisë

23. Neni 59 i Kushtetutës parashikon, midis të tjerash, se Shteti, brenda fuqive të tij kushtetuese dhe mjeteve të disponueshme, si edhe me qëllimin për të ndihmuar industrinë dhe sipërmarrjen private, ka për qëllim të përmbushë nevojat për strehim të qytetarëve të tij. Më tej, ai parashikon se përmbushja e objektivave socialë nuk mund të kërkohen në mënyrë të drejtpërdrejtë me anë të gjykatave. Është ligji ai i cili përcakton kushtet, si edhe masën sipas së cilës një person mund të kërkojë realizimin e këtij objektivi.

24. Neni 101 i Kushtetutës autorizon Këshillin e Ministrave të nxjerrë akte normative në rastet e nevojës dhe të urgjencës. Aktet normative përmbajnë masat paraprake. Ato duhet të miratohen nga Parlamenti në mënyrë që të kenë fuqinë e ligjit.

25. Dispozita të tjera në periudhën konkrete parashikojnë si më poshtë:

Neni 17

"1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.

2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut."

Neni 122

"1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm

juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Ndryshimi, plotësimi dhe shfuqizimi i ligjeve të miratuara me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit për efekt të ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet me të njëjtën shumicë.

2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.

3. Normat e nxjerra prej një organizate ndërkombëtare kanë epërsi, në rast konflikti, mbi të drejtën e vendit, kur në marrëveshjen e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë për pjesëmarrjen në atë organizatë, parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtpërdrejtë i normave të nxjerra prej asaj."

Neni 131

"Gjykata Kushtetuese vendos, për:

a) pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, siç parashikohet në nenin 122;

…

c) pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare;

…

f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave."

Neni 134 §§ 1 (f) dhe 2

"1. Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të:

…

f) partive politike dhe organizatave të tjera;

g) individëve.

2. Subjektet e parashikuara në paragrafin e parë, shkronjat … "f" dhe "g" mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre."

2. Kodi i Procedurës Civile ("KPC")

26. Sipas nenit 609 të KPC-së, një debitor mund të kërkojë te gjykatat vendëse të marrë një titull ekzekutiv, i deklaruar i pavlefshëm, ose ku të deklarohet se detyrimi nuk ekziston ose se ekziston në një shumë më të vogël, ose se më vonë ka pushuar së ekzistuari.

27. Sipas nenit 610 të KPC-së, palët mund të ankohen në një gjykatë për një akt ose për mosveprimin e një përmbaruesi brenda pesë ditëve nga akti konkret ose për neglizhencë.

28. Neni 611 i KPC-së parashikon se apelimi përpara gjykatës ndaj veprimeve ose mosveprimeve të përmbaruesit nuk kishte asnjë efekt pezullues ndaj ekzekutimit. Ekzistonte e drejta për t'u ankuar ndaj vendimit të gjykatës.

3. Akti për privatizimin e njësive shtetërore të banimit (ligji nr. 7652, i datës 23 dhjetor 1992, i ndryshuar)

29. Akti kishte për qëllim të privatizonte njësitë shtetërore të strehimit dhe të krijonte një treg të lirë për strehimin, duke iu mundësuar qiramarrësve të ktheheshin në këtë mënyrë në pronarë. Familjet, të cilat jetonin në apartamentet shtetërore, sipas marrëveshjes së qirasë, mund t'i blinin ato apartamente dhe të bëheshin pronare pasi të përmbushnin një veprimesh, si për shembull, pagesa e çmimit të plotë të privatizimit dhe regjistrimi i pronës në zyrën përkatëse për regjistrimin e tokës.

30. Seksioni 16 i aktit parashikonte që qytetarët e pastrehë kishin të drejtën të merrnin hua nga institucionet financiare për të zgjidhur nevojat e tyre për strehim. Pagesat e interesave do të mbuloheshin nga Shteti me anë të Entit Kombëtar të Banesave ("EKB").

Seksioni 19 parashikonte se qiraja për njësitë e strehimit, të cilat më herët kishin qenë pronë private, do të liberalizoheshin nga muaji dhjetor 1995.

Seksioni 21 parashikonte se njësitë shtetërore të strehimit, të cilat më herët kishin qenë pronë private, nuk u privatizuan sipas aktit.

Seksioni 25 parashikonte se Shteti do të garantonte banesa me qira, të cilat do të ndërtoheshin në të ardhmen, për, *inter alia,* qiramarrësit [të cilët duhej të lironin njësinë e banimit në mënyrë që ajo t'i rikthehej ish-pronarit], të cilët jetonin në banesa që i përkisnin ish-pronarëve.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 11/93

31. Në vendimin nr. 11, të datës 27 gusht 1993, Gjykata Kushtetuese vendosi, *inert alia,* se nuk kishin rezultuar diskriminime nga prania e dy

kategorive të qiramarrësve, sipas parashikimit të ligjit vendës. Vendimi, për sa ka të bëjë me situatën, parashikon si më poshtë:

"Gjykata [Kushtetuese] vëren se [akti për privatizimin e njësive shtetërore të banimit] dhe [akti për rikthimin dhe kompensimin e pronave] kontrollojnë problemet për privatizimin e njësive shtetërore të banimit dhe të rikthimit të pronave ish-pronarëve ose problemet për kompensimin e tyre.

Sipas të dy ligjeve, qiramarrësit e njësive shtetërore të banimit kanë të drejtën t'i marrin ato në pronësi private në përputhje me kushtet e parashikuara në ligj. Për të zgjidhur nevojat e tyre për strehim, qiramarrësit e banesave të cilat i janë rikthyer ish-pronarëve iu është dhënë e drejta të marrin hua nga institucionet financiare, pagesat e interesit të të cilave... duhet të mbulohen nga Shteti, ashtu siç parashikohet shprehimisht në seksionin 16 të aktit, ose ndryshe, duhet të strehohen si qiramarrës në njësitë e banimit që do të ndërtohen nga Shteti sipas seksionit 25 të po këtij akti.

Zgjidhjet e ndryshme për problemet e strehimit, të cilat përfshijnë këto kategori qiramarrësish, nuk lindin nga ndonjë lloj diskriminimi midis tyre, por janë rezultat i statuseve të ndryshme që gëzojnë ata: të parët janë qiramarrësit e njësive shtetërore të banimit, të dytët janë qiramarrësit e banesave të cilat i janë rikthyer ish-pronarëve."

4. Akti për rikthimin dhe kompensimin e pronave (ligji nr. 7698 i datës 15 prill 1993, i ndryshuar nga ligjet nr. 7736 dhe 7765 të vitit 1993, ligjet nr. 7808 dhe 7879 të vitit 1994, ligji nr. 7916 i vitit 1995 dhe ligji nr. 8084 i vitit 1996 dhe i shfuqizuar nga ligji nr. 9235 i datës 29 korrik 2004, dhe i ndryshuar nga ligji nr. 9388 i vitit 2005 dhe ligji nr. 9583 i vitit 2006) ("Akti i pronës").

32. Sipas aktit të pronës, ish-pronarët e pronave, të shpronësuar nga regjimi i kohës dhe trashëgimtarët e tyre ligjorë kishin të drejtën të kërkonin pronësinë ndaj pronave fillestare. Me caktimin e pronësisë, ata do të kishin të drejtën ose t'iu jepej prona fillestare e paluajtshme ose t'iu jepej kompensim në një nga format e parashikuara në ligj.

Parashikime të tjera nga akti i pronës janë pasqyruar më poshtë.

a) Akti i pronës i vitit 1993

33. Dispozita përkatëse e aktit të pronës i vitit 1993 parashikonte:

Seksioni 14

"Marrëdhënia midis qiramarrësve dhe ish-pronarëve, të cilët bëhen pronarë, në bazë të këtij ligji, do të drejtohet nga [akti për privatizimin e njësive shtetërore të banimit].

Në rast se... ish-pronari i garanton qiramarrësit strehim brenda së njëjtës zonë administrative lokale, me një sipërfaqe e cila është në përputhje me normat e strehimit në fuqi, ... qiramarrësi do të jetë i detyruar të lirojë banesën.

Shteti është i detyruar të zgjidhë nevojat për strehim të qiramarrësve aktual në përputhje me normat aktuale të strehimit, duke i dhënë prioritet familjeve me mjete të kufizuara financiare.

Sipas kërkesës së tyre, ish-pronarët mund të kompensohen në një nga format e përcaktuara në këtë ligj."

b) Akti i pronës 2004

34. Për sa ka të bëjë me situatën, akti i pronës i vitit 2004, i cili zëvendëson aktin e pronës të vitit 1993, parashikonte:

Seksioni 9

"Pronat të cilat janë prona të ish-pronarëve duhet të lirohen nga qiramarrësi(t) brenda tre vjetësh. Qiramarrësit do të vijojnë të paguajnë qiranë e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave për dy vjet pas hyrjes në fuqi të këtij akti. Këshilli i Ministrave do të jetë përgjegjës për strehimin e qiramarrësve të pastrehë duke garantuar një banesë me një qira të ulët, një hua me interes të ulët ose një banesë, qiraja e së cilës mbulohet nga Shteti."

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 26/05

35. Në vendimin e saj nr. 26, të datës 2 nëntor 2005, Gjykata Kushtetuese rrëzoi seksionin 9 (1) të aktit të pronës së vitit 2004. Ajo i dha rëndësi faktit se parashikimi në fjalë e kishte përkeqësuar statusin e qiramarrësve po të bëhej një krahasim me parashikimet që kishin ekzistuar përpara se të hynte në fuqi akti i pronës i vitit 2004. Kështu, u konstatua se ndryshimi në legjislacion nuk kishte respektuar parimin e sigurisë ligjore. Gjykata arriti në përfundimin se një kufizim në të drejtën e qiramarrësve për strehim nuk mund të

justifikohej nga interesi publik në mbështetjen e të drejtave të ish-pronarëve për pronën.

c) Akti i pronës 2006

36. Në vijim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese të cituar më sipër, në vitin 2006, legjislatura ndryshoi seksionin 9 të aktit të vitit 2004, si më poshtë:

Seksioni 9

"Pronat, të cilat janë pronë e ish-pronarëve dhe të cilat u lëshuan për qiramarrësit nga shteti përpara hyrjes në fuqi të [aktit për njësitë e shtetërore të strehimit], të cilat përdoren për nevoja strehimi, do të transferohen nën pronësinë e ish-pronarit(ve), në momentin kur përmbushet një nga kushtet e mëposhtme:

a) Nevojat për strehim të qiramarrësve janë përmbushur në çdo mënyrë tjetër të ligjshme;

b) Ish-pronari i garanton qiramarrësve një banesë, e cila ka një sipërfaqe jo më të vogël sesa banesa të cilën ata po përdorin dhe e cila është në një gjendje afërsisht të ngjashme dhe brenda së njëjtës zonë të njësisë administrative vendore, deri në momentin kur nevojat për strehim të qiramarrësve të përmbushen në një nga mënyrat e tjera të parashikuara nga ky seksion.

c) Qiramarrësit lidhin një kontratë qiraje me një institucion financiar, në zbatim të paragrafëve të parë dhe të dytë të seksionit 25 (3) të [programeve sociale për strehimin e banorëve të aktit për zonat urbane]"

...

4. Personat e pastrehë, të cilët janë qiramarrës në banesa që janë prona të ish-pronarëve dhe, të cilët nuk kanë lidhur kontratë qiraje në zbatim të nënparagrafit (c) të paragrafit të parë të këtij seksioni, ose të cilëve nuk iu është garantuar strehim në përputhje me nënparagrafët (a), (c) dhe (d), të paragrafit të parë të këtij seksioni, e humbasin të drejtën për të marrë në pronësi banesën, më 31 dhjetor 2008. Atyre do t'iu ofrohen programe për banesat sociale, sipas seksionit 4 të programeve sociale për strehimin e banorëve të aktit për zonat urbane. Ish-pronarit i jepet e drejta të marrë pronësinë e ligjshme të banesës, sipas titullit të tij ligjor.

5. Qiraja për banesat e zëna nga personat e pastrehë, sipas parashikimit të paragrafit 1 të këtij seksioni, indeksohet sipas të dhënave të INSTAT-it, bazuar në çmimin vjetor dhe rritjet e pagave. Qëllimi i tij është mbulimi i shpenzimeve të pronarit për mirëmbajtjen dhe miradministrimin e banesës...".

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 11/07

37. Në vendimin nr. 11, të datës 4 prill 2007, Gjykata Kushtetuese rrëzoi seksionin 9 të aktit të pronës të vitit 2006. Ajo ndoqi të njëjtën linjë arsyetimi si në vendimin e saj nr. 26/05. Ajo rekomandonte se Këshilli i Ministrave duhej të paraqiste masa të reja legjislative për të mbushur vakumin ligjor.

5. Akti normativ i vitit 2012

a) Prezantimi i aktit

38. Më 1 gusht 2012, Qeveria nxori aktin normativ për lirimin e pronave të ish-pronarëve, të cilat ishin zënë nga qiramarrësit. Do të nxirreshin nga banesat vetëm ata qiramarrës, emrat e të cilëve ishin transferuar në Bankë për të marrë një hua me interes zero për një periudhë 30-vjeçare për blerjen e një apartamenti. Lista e qiramarrësve të pastrehë në pritje për të marrë një hua do të hartohej nga EKB-ja dhe do të paraqitej në Bankë, më 5 shtator 2012. Afati për të liruar vullnetarisht pronat u përcaktua data 1 nëntor 2012.

39. Në rastin kur një apartament nuk lirohej vullnetarisht brenda afatit kohor të parashikuar, EKB-ja, me anë të një njoftimi me shkrim të ish-pronarit, do të lëshonte një urdhër për nxjerrjen nga banesa, i cili do të konsiderohej një vendim i ekzekutueshëm sipas interpretimit të Kodit të Procedurës Civile. Më pas, EKB-ja do t'i kërkonte Gjykatës së Rrethit të lëshonte një vendim gjykate për zbatimin e urdhrit për lirimin e apartamentit. Seksioni 3 përjashton pezullimin e ekzekutimit të vendimit të gjykatës për zbatimin e urdhrit.

40. Përveç huas me interes zero për një periudhë 30-vjeçare, seksioni 4 i aktit normativ parashikon, gjithashtu, strehimin social me qira, të ofruar nga këshillat bashkiakë dhe vendosjen e të moshuarve, të cilët nuk mund të kujdeseshin për veten ose të cilët nuk kishin mjetet për të paguar strehim social me qira, në shtëpitë e të moshuarve.

b) Opinioni i Avokatit të Popullit

41. Më 10 shtator 2012, Avokati i Popullit lëshoi një opinion publik në lidhje me aktin normativ të vitit 2012. Ai shprehu mendimin se boshllëku ligjor, i shkaktuar nga rrëzimi i

seksionit 9, të aktit të pronës së vitit 2006, duhej të ishte plotësuar nga Parlamenti në vend që të plotësohej nga Qeveria; se nuk kishte pasur studime të detajuara në lidhje me statusin e familjeve të pastreha; se afatet kohore të përcaktuara nga akti normativ ishin jashtëzakonisht të shkurtra dhe nuk lejohej një pezullim i ekzekutimit, dhe se asnjë interes publik nuk justifikonte shkeljen e parimit të sigurisë ligjore. Së fundmi, ai arrinte në përfundimin se akti normativ i vitit 2012 nuk ishte në përputhje me Kushtetutën.

c) Sesioni parlamentar i datës 13 shtator 2012

42. Më 13 shtator 2012, Parlamenti shpalli miratimin e aktit normativ. Sipas të dhënave të seancës së po së njëjtës ditë, shumica e deputetëve të Parlamentit ("Deputetët") pohuan se kishte 3,157 familje të cilat jetonin si qiramarrës në banesa të rikthyera ish-pronarëve, 1,000 prej të cilave kishin aplikuar për një hua në Bankë, nga të cilat 285 tashmë kishin marrë një hua. Programi që garantonte një hua me zero interes, çka nënkuptonte se pagesat e interesit do të mbuloheshin nga Shteti, ekzistonte që prej vitit 2009.

43. Sipas deputetëve të opozitës, kalimi i aktit normativ ishte i nxituar dhe kërkonte diskutime të specializuara dhe më të gjera. Ata kërkonin që opinioni i Avokatit të Popullit të qarkullonte te deputetët.

d) Procedimet përpara Gjykatës Kushtetuese

44. Më 20 gusht 2012, Shoqata paraqiti një ankesë kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese, duke kundërshtuar kushtetutshmërinë e aktit normativ të vitit 2012 dhe të ligjit të datës 13 shtator 2012, i cili shprehte miratimin ndaj tij. Shoqata parashtroi se zgjidhjet e parashikuara nga akti normativ i vitit 2012 nuk përputheshin me parimin e sigurisë ligjore. Ato ishin në dëm të qiramarrësve duke hequr detyrimin e Shtetit për të ofruar strehim për këtë kategori. Ato ishin diskriminuese *vis-a-vis* ndaj atyre qiramarrësve të cilët kishin përfituar strehim në zbatim të aktit për Kontributin Shtetëror për Familjet e Pastreha të vitit 1995.

45. Gjithashtu, Shoqata pohoi se situata duhej të ishte kontrolluar nga një akti i Parlamentit në vend që të kontrollohej nga një akt normativ i paraqitur nga qeveria. Në vijim, ajo i kushtoi vëmendje mungesës së mundësisë për të kundërshtuar pezullimin e zbatimit dhe faktit se qiramarrësit duhej të lironin vullnetarisht apartamentet brenda një afati kohor të shkurtër, më konkretisht më 1 nëntor 2012.

46. Në parashtrimet e saj shtesë të datës 23 tetor 2012, Shoqata pohonte se akti normativ i vitit 2012 nuk garantonte zgjidhje efikase për arsyet e mëposhtme: njësitë e qeverisjes vendore nuk zotëronin fondet dhe mjetet e nevojshme për të ofruar strehim social, Banka nuk kishte mjaftueshëm fonde për t'i ofruar hua çdo familje të pastrehë; shumica e kërkuesve, për shkak të moshës, fitimeve të pamjaftueshme, të dhënave të mëparshme kriminale dhe mungesës së kolateralit, nuk do të ishin kurrë të përshtatshëm për marrjen e një huaje.

47. Në parashtrimet e tyre me shkrim të datës 23 tetor 2012, Gjykata Kushtetuese, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit parashtruan se që prej vitit 2008, Qeveria po zbatonte një skemë financimi për huat me interes zero për familjet e pastreha, të cilat jetonin në banesa që i përkisnin ish-pronarëve. Statistikat tregonin se nga 3,157 familje të regjistruara si të pastreha, 999 prej tyre kishin aplikuar për hua me interes zero, prej të cilave vetëm 285 kishin lidhur kontrata për disbursim me Bankën. Edhe pse ishin miratuar hua për familjet e tjera të pastreha, ato ishin vonuar në nënshkrimin e dokumenteve për disbursimin e tyre. Në lidhje me vonesat e shkaktuara nga familjet e pastreha në aplikimin për hua me interes zero dhe në vijim vonesat për nënshkrimin e dokumenteve për disbursimin e tyre, Qeveria nxori aktin normativ, si një çështje urgjente. Akti normativ kishte zgjidhur problematikat e të drejtave të pronave të ish-pronarëve në lidhje me nenin 1 të protokollit nr. 1 të Konventës dhe kishte shmangur që Shteti të kishte detyrimin për të paguar pretendimet për dëmshpërblim të lartë. Sipas tyre, nuk kishte pasur një shkelje të parimit për siguri ligjore, duke qenë se problemi i familjeve të pastreha kishte qenë objekt diskutimesh për njëzet vitet e kaluara. Për më tepër, akti normativ parashikonte strehim në strehat e të moshuarve për të moshuarit, të cilët nuk përmbushnin kërkesat të përfitonin një hua.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 1/13

48. Më 31 tetor 2012, Gjykata Kushtetuese informoi Shoqatën se e kishte rrëzuar ankesën e saj kushtetuese. Vendimi i arsyetuar ishte i disponueshëm më 6 shkurt 2013 (vendimi nr. 1/13).

49. Gjykata Kushtetuese konstatoi se Shoqata kishte pozicion ligjor për sa i përket statusit të saj, aktit të përfshirjes, natyrës së aktivitetit të saj dhe natyrës së aktit normativ, të cilin e kishte kundërshtuar. Ajo konstatoi se kishte një lidhje midis qëllimit për të cilin ishte themeluar Shoqata dhe çështjes kushtetuese të paraqitur për shqyrtim përpara Gjykatës Kushtetuese.

50. Për sa u përket meritave të çështjes, Gjykata Kushtetuese konstatoi se, sipas nenit 101 të Kushtetutës, ishte nevoja dhe urgjenca për njohjen e aktit normativ 2012. Një gjë e tillë diktohej nga fakti se ish-pronarët kishin pritur për njëzet vjet të fitonin titullin ndaj banesave që iu ishin rikthyer. Po kështu, një gjë e tillë kushtëzohej nga zbatimi i vendimit pilot të Gjykatës së Strasburgut në çështjen *Manushaqe Puto dhe të Tjerët* (cituar më sipër), në lidhje me zbatimin e vendimeve të formës së prerë të cilët njihnin të drejtën e ish-pronarëve për rikthimin e pronave të tyre, ose në vend të rikthimit, të drejtën për kompensimin e tyre. Në vijim, ajo iu referua gjetjeve të Gjykatës së Strasburgut në çështjet *Beshiri dhe të Tjerët kundër Shqipërisë* (nr. 7352/03, e datës 22 gusht 2006), *Driza* (cituar më sipër) dhe *Ramadhi dhe të Tjerët* (cituar më sipër) dhe nënvizoi dështimet sistematike të sistemit vendës për të respektuar të drejtën e ish-pronarëve për të gëzuar pasuritë në paqe. Për këtë arsye, ajo gjykoi se akti normativ kishte krijuar ekuilibrin e drejtë midis të drejtave të qiramarrësve dhe të drejtave të ish-pronarëve për pronën.

51. Për sa i përket testit të proporcionalitetit, Gjykata Kushtetuese gjykoi se akti normativ parashikonte një hua prej tridhjetë vitesh me 0% interes, teksa pagesat do të mbuloheshin nga Shteti. Interesi, që do të paguhej, do të kalonte principalin që do të merrej si hua nga një qiramarrës. Gjithashtu, akti normativ parashtronte detyrime të tjera pozitive për Shtetin, të tilla si parashikimi i një banese sociale për këta qiramarrës nga njësitë e qeverisjes vendore, si edhe vendosja në strehat për të moshuarit e personave të moshuar, të cilët nuk ishin në gjendje të kujdeseshin për veten e tyre ose nuk kishin askënd për t'u kujdesur për ta. Sipas konsideratës së gjykatës, kjo tregonte se Shteti kishte bërë mjaftueshëm përgatitje për grupet vulnerabël. Strehimi i këtyre individëve ishte një detyrë e ndarë midis Shtetit dhe vet individëve. Nuk mund të thuhej se masat e propozuara ishin arbitrare, të padrejta ose të bazuara në një vlerësim të paarsyetueshëm. Por ato nuk mund të konsideroheshin as të rrepta; në të kundërt, ato ishin më favorizuese. Detyrimi i qiramarrësve për të liruar banesat ishte i nevojshëm dhe ndërhyrja justifikohej nga interesi publik.

52. Gjykata Kushtetuese e kundërshtoi ankesën e Shoqatës se gjykatat nuk mund të pezullonin zbatimin, për arsyen se fuqitë e saj për rishikim kushtetues nuk shtriheshin në çështje të cilat kishin të bënin me interpretimin, zbatimin dhe harmonizimin e ligjeve vendëse.

e) Urdhri i Ministrisë së Zhvillimit Urban, i datës 23 dhjetor 2013

53. Më 23 dhjetor 2013, Ministria e Zhvillimit Urban lëshoi një urdhër ("Urdhri i Ministrisë") sipas të cilit EKB-ja, përpara dorëzimit të kërkesës në Gjykatën e Rrethit për lëshimin e urdhrit gjyqësor për zbatim, duhej të kontrollonte nëse qiramarrësit kishin përfituar një hua dhe/ose strehim në përputhje me ligjin vendës. Gjithashtu, u vendos se një kërkesë e tillë nuk mund të paraqitej gjatë periudhës së dimrit. Në vijim, ajo parashikoi një sërë masash mbrojtëse në rastin e një familje, duke përfshirë të moshuar, fëmijë, persona me aftësi të kufizuar, ose nëse kushtet e strehimit ishin jashtë standardeve normale të jetesës. Në një rast të tillë, familja përfitonte strehim social me qira ose një bonus strehimi. Në zbatim të seksionit 4 të aktit normativ 2012, EKB-ja i duhej të kërkonte urgjentisht që këshillat bashkiakë të vinin në dispozicion strehimin social me qira. Rezulton se në mbështetje të këtij urdhri, EKB-ja i pezulloi procedurat përmbarimore për tetëmbëdhjetë familje me qira.

f) Procedime të tjera vendëse

54. Në një datë të paspecifikuar, F.B. dhe Sh.B., qiramarrës, ndërmorën procedura gjyqësore, sipas neneve 609, 610 dhe 611 të KPC-së, duke kundërshtuar urdhrin për nxjerrjen

nga banesa të EKB-së, urdhrin përmbarimor të Gjykatës së Rrethit dhe veprimet e përmbaruesit të ndërmarra sipas njohjes së aktit normativ 2012. Në këtë rast, F.B. dhe Sh.B dhe ish-pronarët kishin lidhur një marrëveshje qiraje bazuar në vendimin e formës së prerë të gjykatës, i cili kishte detyruar qiramarrësit të paguanin një qira, sipas parashikimit të Këshillit të Ministrave në favor të ish-pronarëve.

55. F.B. dhe Sh.B. deklaruan përpara gjykatave vendëse se ata nuk ishin të detyruar të lironin banesat përderisa marrëveshja e qirasë ishte e vlefshme dhe ende në fuqi. Gjithashtu, urdhri për nxjerrjen nga banesa ishte lëshuar nga EKB-ja, e cila nuk kishte juridiksion për të marrë një vendim për mosmarrëveshjen civile në fjalë. Për pasojë, edhe veprimet e përmbaruesit ishin të pavlefshme. Gjithashtu, urdhri përmbarimor i lëshuar nga Gjykata e Rrethit ishte i pavlefshëm përderisa EKB-ja nuk kishte qenë kreditori. Vetëm ish-pronarët duhej t'i kërkonin gjykatës së rrethit të lëshonte një urdhër përmbarimor. Në vijim, qiramarrësit pretenduan se akti normativ i vitit 2012 nuk mbronte në mënyrë proporcionale të drejtën e qiramarrësve për respektimin e banesave të tyre. Për më tepër, ata e kishin të pamundur të merrnin një hua me 0% interes për shkak të mungesës së mjeteve të tyre financiare (ata ishin të papunë dhe nuk zotëronin ndonjë pasuri të paluajtshme) dhe moshës. Gjithashtu, ata parashtruan se veprimet e realizuara nga përmbaruesi ishin në shkelje në nenin 8 të Konventës, përderisa nuk kishin qenë proporcionale, për arsye se nuk kishin krijuar një ekuilibër midis interesave të ish-pronarëve dhe qiramarrësve. Së fundmi, ata i kërkuan Gjykatës së Rrethit të pezullonte procedurat përmbarimore dhe ta dërgonte çështjen për gjykim përpara Gjykatës Kushtetuese për mungesë kushtetueshmërie të aktit normativ 2012.

56. Më 12 prill 2013, Gjykata e Rrethit Tiranë e rrëzoi masën me arsyetimin se me hyrjen në fuqi të aktit normativ 2012, marrëveshja e qirasë e lidhur midis qiramarrësve dhe ish-pronarit nuk kishte më efekt detyrues. Për pasojë, nxjerrja nga banesa kishte qenë e ligjshme dhe qiramarrësit ishin të detyruar të lironin banesën në favor të ish-pronarëve. Gjithashtu, Gjykata e Rrethit vërente se qiramarrësit kishin paraqitur dokumente mbështetëse për të provuar pretendimin e tyre se nuk zotëronin ndonjë pronë të paluajtshme ose ndonjë mjet tjetër financiar dhe në të vërtetë, ata merrnin pension për shkak të moshës ose për aftësi të kufizuara. Megjithatë, ajo argumentoi se këto nuk ishin arsye për të kundërshtuar një vendim të ekzekutueshëm sipas nenit 609 të KPC-së.

57. Gjykata e Rrethit e kundërshtoi pretendimin e paditësve ndaj urdhrit të zbatimit për arsyen se EKB-ja përmbushte kërkesat, që sipas aktit normativ 2012, EKB-ja t'i kërkonte gjykatës së rrethit lëshimin e një urdhri zbatimi.

58. Gjithashtu, Gjykata e Rrethit kundërshtoi masën, sipas nenit 610 të KPC-së ndaj veprimeve të përmbaruesit, me arsyetimin se ekzekutimi tashmë ishte realizuar, më konkretisht banesa tashmë ishte liruar në favor të ish-pronarit. Për më tepër, ajo arsyetonte se duke qenë se qiramarrësit i kishin kundërshtuar veprimet e përmbaruesit me arsyetimin se vendimi i ekzekutueshëm ishte i pavlefshëm, për aq kohë sa vendimi ishte i vlefshëm, po kështu ishin edhe veprimet e përmbaruesit.

59. Për sa i përket aplikimit të qiramarrësve për ta dërguar çështjen për gjykim përpara Gjykatës Kushtetuese, Gjykata e Rrethit e pushoi atë si haptazi të pabazuar në fakte, në këndvështrimin se Gjykata Kushtetuese tashmë e kishte shqyrtuar kushtetueshmërinë e atij akti në vendimin e saj nr. 1/13.

60. Në lidhje me pezullimin e procedurave përmbaruese, Gjykata e Rrethit në seancën e parë tashmë e kishte rrëzuar kërkesën me anë të një vendimi interlokutor me arsyetimin se ndërkohë, qiramarrësit tashmë ishin nxjerrë nga banesat. Për më tepër, qiramarrësit nuk kishin paraqitur të dhëna për të provuar ekzistencën e një dëmi të pariparueshëm. Në vendimin e saj, të datës 12 prill 2013, mbi themelin e çështjes, Gjykata e Rrethit arsyetonte se neni 611 i KPC-së në lidhje me pezullimin e procedurave përmbaruese prevalonte ndaj seksionit 3 të aktit normativ 2012, i cili përjashtonte pezullimin e zbatimit.

61. Vendimi i Gjykatës së rrethit u la në fuqi nga Gjykata e Apelit, më 7 tetor 2014. Megjithatë, Gjykata e Apelit theksoi se vlerësimi i Gjykatës së Rrethit në lidhje me pezullimin e procedurave përmbaruese ishte i gabuar, duke qenë se akti normativ 2012, si *lex specialis*,

prevalonte ndaj parashikimeve të KPC-së. Qiramarrësit nuk paraqitën ankesë në Gjykatën e Lartë për arsyen se godina ishte shembur ndërkohë.

62. Në dy raste të tjera, qiramarrës të tjerë kishin ndërmarrë procedura gjyqësore, sipas neneve 609–612 të KPC-së, duke kundërshtuar urdhrin për nxjerrjen nga godina të EKB-së, urdhrin përmbarimor të Gjykatës së Rrethit dhe masat vijuese të përmbarimorit. Përfaqësuesi i qiramarrësve kishte paraqitur ankesë tek Avokati i Popullit në lidhje me kohëzgjatjen e paarsyeshme të procedurave gjyqësore. Megjithatë, një nga çështjet u ndërpre me arsyetimin se qiramarrësit nuk kishin qenë të pranishëm në seancën gjyqësore pa asnjë arsye çfarëdo. Në rastin tjetër, qiramarrësit nuk kishin paraqitur adresën e duhur në gjykatën e rrethit. Rezulton se të dy vendimet ishin bërë të formës së prerë.

ANKESA

63. Kërkuesit u ankuan, bazuar në nenin 8 të Konventës, se nxjerrja nga banesat e tyre pa ndërmarrjen e masave të duhura nga ana e autoriteteve për t'i garantuar atyre strehim alternativ (aspekt substantiv) dhe pa pasur akses në një mjet gjyqësor, i cili do t'i kishte lejuar gjykatat vendëse të vlerësonin proporcionalitetin e nxjerrjes së tyre nga banesat (aspekti procedural), ishte shkelje e së drejtës së tyre për respektimin e banesës.

LIGJI

64. Duke qenë se kërkesat ngrenë të njëjtën problematikë, Gjykata vendos se kërkesat duhet të bashkohen sipas Rregullit 42 § 1 të Rregullave të Gjykatës.

65. Kërkuesit u ankuan se nxjerrja e tyre nga banesat, sipas urdhrit të autoriteteve në zbatim të aktit normativ 2012, përbënte një shkelje të nenit 8 të Konventës. Ky nen parashikon si më poshtë:

"1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve."

A. Parashtrimet e palëve

66. Sipas informacioneve të dhëna nga EKB-ja, më 23 prill 2015, Qeveria parashtroi se EKB-ja kishte lëshuar urdhra për nxjerrjen nga banesat vetëm për familjet (Bakiu (kërkesa nr. 43928/13), Vincani (kërkesa nr. 44150/13), Ilirjan Subashi (kërkesa nr. 44153/13), Spahiu (kërkesa nr. 44522/13) dhe Batku (kërkesa nr. 44107/13), vetëm kërkuesit, pjesë e këtyre familjeve, mund të konsideroheshin si viktima. EKB-ja nuk lëshoi urdhra për nxjerrjen nga banesa për familjet Lulzim Dhimitri (kërkesa nr. 44542/13), Xhillari (kërkesa nr. 44147/13), Nikolla (kërkesa nr. 44140/13) dhe Bujar Subashi (kërkesa nr. 44152/13), me arsyetimin se ajo kishte refuzuar informacionin me shkrim të dorëzuar nga ish-pronarët së bashku me dokumentacionin e tyre. Në lidhje me tetë familjet e tjera, ish-pronarët nuk paraqitën asnjëherë informacion me shkrim përpara EKB-së. Për më tepër, Qeveria parashtroi se kërkuesit e tjerë (duke përfshirë pesë familjet të cilat tashmë ishin nxjerrë nga banesat), emrat e të cilave nuk u përmendën, nuk kishin një marrëveshje të sigurt qiramarrje, sepse këto familje jetonin jashtë vendit. Për këtë arsye, ata nuk mund të pretendonin të ishin viktima.

67. Gjithashtu, Qeveria argumentoi se kërkuesit nuk kishin shteruar mjetet vendëse, më konkretisht: një ankesë kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese ndaj aktit normativ 2012, i cili ishte provuar se ishte në fuqi në vitin 1993, në situatën e cila kishte të bënte me të drejtat e qiramarrësve në lidhje me pronat private. Në procedurat përpara Gjykatës Kushtetuese në vitin 2012, Shoqata, e cila nuk ishte njohur si viktimë, por përkundrazi, ishte gjykuar se kishte një pozitë ligjore, nuk kishte vepruar në emër të kërkuesve. Për këtë arsye, kërkuesit kishin alternativën e hapur për të paraqitur një ankesë kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese.

Për më tepër, kërkuesit mund të kishin kërkuar kompensim për situatat e tyre individuale përpara gjykatave vendëse. Kërkuesit kishin pasur mundësinë t'i adresoheshin gjykatave vendëse për të kundërshtuar paligjshmërinë ose rrethanat e faktit, ose aktin individual, ose ligjin, si rezultat i zbatimit të aktit normativ 2012. Parashikimi për mospezullimin e titujve ekzekutiv nga gjykatat vendëse nuk i pengonte kërkuesit të bënin një gjë të tillë.

68. Gjithashtu, Qeveria argumentoi se çështja ishte paraqitur në gjykatë përtej afatit gjashtëmujor, duke nisur nga ditë në të cilën ishte

njohur akti normativ 2012, ose dita në të cilën Parlamenti kishte miratuar ligjin i cili mbështeste aktin normativ 2012. Sipas Qeverisë, përllogaritja e kohës nuk mund të kishte filluar që nga dhënia e vendimit të Gjykatës Kushtetuese të datës 31 tetor 2012, duke qenë se vet kërkuesit nuk kishin paraqitur një ankesë kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese.

69. Kërkuesit argumentuan se ata ishin nxjerrë nga banesat pas lëshimit të urdhrave përmbarimor nga gjykatat vendëse. Për pasojë, ata duhej të konsideroheshin viktima sipas Konventës.

70. Gjithashtu, kërkuesit argumentuan se në zbatim të ligjit vendës, ata nuk ishin lejuar të paraqisnin një kërkesë kushtetuese. Edhe nëse sipas ligjit vendës ata do të kishin pozitën për të paraqitur një ankesë kushtetuese, do të kishte qenë e vështirë që kërkuesit të ishin më të suksesshëm sesa kishte qenë Shoqata me ankesën e saj. Kërkuesit kishin qenë të gjithë anëtarë të Shoqatës, e cila ishte themeluar me idenë për të mbrojtur të drejtat e tyre për strehim përpara gjykatave vendëse. Ata theksuan se çështja e tyre ishte e ngjashme me çështjen *Berger-Krall dhe të Tjerët kundër Sllovenisë (nr. 14717/04), (vend.) 28 maj 2013)*, ku Gjykata ishte përballur me një situatë të ngjashme dhe kërkuesit në atë çështje ishin mbështetur në rezultatin e procedurave kushtetuese të ndërmarra nga një Shoqatë e cila përfaqësonte interesat e tyre.

71. Në vijim, ata theksuan se Qeveria kishte përmendur tërthorazi, pa dhënë detaje të tjera dhe pa paraqitur ndonjë praktikë gjyqësore për të provuar efikasitetin, se një masë sipas neneve 609 dhe 610 të KPC-së nuk do të kishte qenë efikase për arsyet e mëposhtme:

1) Akti normativ 2012, në seksionin e tij 3, nuk parashikonte ndonjë kërkesë për pezullim ndaj një vendimi të ekzekutueshëm të miratuar sipas këtij akti; 2) dhe nëse do të ishte paraqitur një kërkesë për pezullimin e nxjerrjes nga banesa, do të ishte kundërshtuar në themel, për arsye se sipas vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë, të datës 24 mars 2004, në lidhje me dhënien e masave të përkohshme, një masë e përkohshme do të mund të garantohej nën rrethana të kufizuara dhe asnjëherë në rastin kur rezultati i një kërkese të përkohshme do të kishte pasur të njëjtin efekt si ai i kërkesës kryesore – kërkuesit theksuan se në çështjen konkrete si kërkesa e përkohshme edhe ajo kryesore do të kishin pasur të njëjtën përmbajtje: kërkesën për të mos u nxjerrë nga banesa pa iu garantuar akomodim i përshtatshëm alternativ; 3) disa qiramarrës të tjerë, me anë të ndihmës nga përfaqësuesit ligjorë të kërkuesve, i kishin kundërshtuar urdhrat për nxjerrjen nga banesa në gjykatat vendëse, por pa sukses (shih paragrafët 54–62 më sipër) – në çështjen F.B. dhe Sh.B., Gjykata e Rrethit nuk i ishte adresuar kërkesave të nenit 8 dhe ishte kufizuar me konstatimin se duke qenë se Gjykata Kushtetuese tashmë kishte konstatuar se akti normativ ishte në zbatim të Kushtetutës, ajo nuk mund të vepronte ndryshe veçse të rrëzonte pretendimin. Gjithashtu, kërkuesit parashtruan se gjykata e rrethit nuk kishte vlerësuar proporcionalitetin e nxjerrjes nga banesa edhe pse kishte pranuar se qiramarrësit kishin provuar se ata ishin të varfër, se merrnin pension për moshën dhe për aftësi të kufizuara dhe se nuk zotëronin pronë tjetër; gjithsesi gjykata e rrethit kishte gjykuar se nxjerrja nga banesa ishte e ligjshme dhe nuk do t'i shkaktonte atyre dëme të pariparueshme. Më tej, ata parashtruan se qiramarrësit nuk bënë apel në Gjykatën e Lartë me arsyen se ndërkohë godina ishte shembur; 4) vendimi nr. 1/13 i Gjykatës Kushtetuese kishte shuar mundësitë për suksesin e ndonjë mjeti tjetër gjyqësor – në çështjen F.B. dhe Sh.B., gjykatat vendëse i ishin referuar shprehimisht dhe kishin respektuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese; 5) ligji shqiptar parashikon të drejtën për strehim si një objektiv social, i cili nuk është i diskutueshëm në nivel gjyqësor me anë të rishikimit gjyqësor. Qeveria e Shqipërisë, në shumë raste, kishte pranuar se urdhri ligjor vendës nuk parashikonte as një mjet më minimal për mbrojtje ndaj nxjerrjes me forcë nga banesa, duke qenë në këtë mënyrë i mangët dhe jo në përputhje me standardet ndërkombëtare përkatëse.

72. Kërkuesit parashtruan se nëse kërkesa kushtetuese e Shoqatës do të duhej të merrej në konsideratë si një mjet efikas, i cili duhej shteruar, atëherë kërkesa e tyre do të duhej të ishte njohur brenda afatit gjashtëmujor. Në çdo rast, afati gjashtëmujor kishte filluar të përllogaritej, në rastin më të hershëm, që prej datës së vendimeve të gjykatave të rrethit, të cilat urdhëronin nxjerrjen e tyre nga banesat.

A. Vlerësimi i Gjykatës

73. Gjykata thekson se parimet e përgjithshme në lidhje me shterimin e mjeteve vendëse përcaktohen në çështjen *Vučković dhe të Tjerët kundër Serbisë* (mospranim paraprak) [DHM], nr. 17153/11 dhe 29 të tjerë, §§ 69–77), 25 mars 2014).

74. Gjykata konstaton se nuk është e nevojshme të adresohen të gjitha çështjet e ngritura nga palët, sepse ankesat e kërkuesve në çdo rast janë të papranueshme për arsyet e mëposhtme.

75. Gjykata vëren se sipas Qeverisë, kërkuesit nuk paraqitën një ankesë kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese, si edhe faktin se ata mund të kishin kërkuar kompensimin për situatat e tyre individuale përpara gjykatave vendëse. Për pjesën e tyre, kërkuesit parashtruan se nuk kishin ndonjë mjet efikas të cilin mund ta përdornin: ata nuk ishin në pozitë ligjore që të paraqisnin një ankesë kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese; në vend të kësaj, Shoqata e kishte bërë një gjë të tillë në emrin e tyre dhe një masë sipas KPC-së nuk do të kishte qenë efikase.

76. Gjykata, duke marrë në konsideratë parashtrimet e kërkuesve se legjislacioni shqiptar nuk garanton mjete efikase në zbatim të nenit 8 të Konventës, vëren se në çështjen konkrete problemi nuk është nëse kërkuesit ngritën, të paktën në thelb, një kërkesë mbështetur në nenin 8 të Konventës në nivel vendës. Problemi është nëse kërkuesit kishin ndonjë mjet efikas në nivel të brendshëm të cilin do të mund ta përdornin. Në këtë mënyrë, Gjykata do t'i adresohet në mënyrë të veçantë aksesit dhe efikasitetit të secilit mjet të kërkuar.

1. Në lidhje me ankesën kushtetuese të Gjykatës Kushtetuese nga kërkuesit

77. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se sipas Kushtetutës së Shqipërisë, kërkuesit si individë privatë, nuk mund të kundërshtojnë kushtetueshmërinë e aktit normativ 2012 për mungesë të pozitës ligjore. Referenca e bërë nga Qeveria ndaj kërkesës kushtetuese e paraqitur nga individët në vitin 1993, është e pavend për aq sa dispozitat kushtetuese gjatë kohës përkatëse lejonin paraqitjen e një ankese kushtetuese nga individët. Për këtë arsye, Gjykata rrëzon kundërshtimin e Qeverisë në lidhje me këtë aspekt.

2. Në lidhje me ankesën kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese nga Shoqata

78. Tashmë, Gjykata do të shqyrtojë nëse ankesa kushtetuese e Shoqatës ishte një mjet efikas. Gjykata vëren se Shoqata kundërshtoi aktin normativ 2012 dhe ligjin në mbështetje të tij - të cilët sipas saj kishin ndikim mbi të drejtat e qiramarrësve - përpara Gjykatës Kushtetuese me anë të një ankese kushtetuese. Gjykata Kushtetuese shqyrtoi ankesën e Shoqatës sipas meritave të saj. Nëse ajo do ta kishte pranuar ankesën e Shoqatës sipas meritave të saj, Gjykata Kushtetuese do të kishte pasur kompetencën të rrëzonte pjesët përkatëse të legjislacionit konkret. Në vijim, Gjykata vëren se me anë të vendimit të saj 1/13, Gjykata Kushtetuese e ka kufizuar veten e saj brenda kompetencave të saj, në shqyrtimin e përgjithshëm të aktit normativ 2012, për faktin nëse akti përputhej me Kushtetutën, dhe jo në pretendimet individuale të kërkuesve individual. Megjithatë, Gjykata vëren se kërkuesit u ankuan përpara saj jo vetëm për faktin se masat e përfshira në aktin normativ 2012 kishin qenë joefikase, por edhe sepse autoritetet nuk kishin marrë masat e duhura për t'iu garantuar atyre strehim alternativ, ndërsa gjykata vendëse nuk kishin vlerësuar proporcionalitetin e nxjerrjes së tyre nga banesa. Duke marrë në konsideratë ankesat e kërkuesve në Gjykatë dhe rrethanat e çështjeve konkrete, Gjykata vëren se nxjerrja nga banesat e kërkuesve, e pretenduar të ishte arbitrare, kërkonte që gjykatat vendëse të vlerësonin me kujdes situatën e tyre individuale. Nën këto rrethana, Gjykata është e mendimit se ankesa kushtetuese e Shoqatës në Gjykatën Kushtetuese, nuk i heq mundësinë individit që të përdorë mjete të tjera ligjore në Gjykatë, të cilat mund të jenë efikase sipas qëllimeve të Konventës (shih, *mutatis mutandis, a contrario, Berger-Krall dhe të Tjerët*, cituar më sipër, § 129).

3. Në lidhje me një pretendim sipas neneve 609 dhe 610 të KPC-së dhe një kërkesë për pezullim të procedurave përmbarimore sipas nenit 611 të KPC-së

79. Gjykata e kupton kundërshtimin e Qeverisë se kërkuesit "mund të kishin kundërshtuar faktin në sistemin e gjykatave vendëse", si një referencë e një mase mbështetur në nenet 609, 610 dhe 611 të KPC-së. Gjykata vëren se sipas nenit 609, një debitor mund të kërkojë përpara gjykatave të brendshme që një

vendim i ekzekutueshëm të deklarohet i pavlefshëm ose të deklarohet se detyrimi nuk ekziston ose se ekziston në një shumë më të vogël ose se më vonë detyrimi ka ndaluar së ekzistuari. Sipas Nenit 610 të KPC-së, palët mund të ankohen në një gjykatë për një veprim ose mosveprim të përmbaruesit brenda pesë ditëve nga veprimi në fjalë. Neni 611 i KPC-së, në kohën konkrete, parashikonte se apeli kundër veprimeve ose mosveprimeve të përmbaruesit nuk kishte efekt pezullues ndaj ekzekutimit, në rast se gjykata nuk vendoste në këtë mënyrë. Kërkuesit argumentuan përpara Gjykatës se këto mjete nuk kishin qenë efikase në situatat e qiramarrësve të tjerë; për këtë arsye, ato nuk ishin efikase në çështjet konkrete.

80. Gjykata vëren se në një çështje tjetër të ngjashme, në nivel vendës, F.B. dhe Sh.B. ndërmorën procedura gjyqësore që kundërshtonin urdhrin e EKB-së për nxjerrjen nga banesa, urdhri për zbatim i Gjykatës së Rrethit dhe masat pasuese të përmbaruesit të ndërmarra pas njohjes së aktit normativ 2012. Më tej, Gjykata vëren se gjykatat civile kishin juridiksion të plotë për shqyrtimin e kërkesave të tilla si ato të cilat ishin në diskutim në çështjen konkrete. Në të vërtetë, në çështjen F.B. dhe Sh.B. (shih paragrafët 54–61 më sipër), gjykatat vendëse pushuan veprimin civil të qiramarrësve me arsyetimin se akti normativ 2012 kishte parashikuar nxjerrjen e tyre nga banesat. Megjithatë, Gjykata vëren se ata qiramarrës nuk apeluan në Gjykatën e Lartë. Gjithashtu, qiramarrës të tjerë i kishin tërhequr paditë e tyre civile përpara gjykatave vendëse (shih paragrafin 62 më sipër), pa i lejuar mundësinë Gjykatës të shqyrtonte qasjen e ndërmarrë nga gjykatat vendëse në lidhje me situatat e tjera individuale. Për këtë arsye, me aq sa ka dijeni Gjykata, asnjë prej kërkuesve, ose ndonjë qiramarrës tjetër, nuk është përpjekur ta paraqesë çështjen te gjykatat vendëse. Me pak fjalë, nuk ka pasur një vlerësim individual gjyqësor për rrethanat e nxjerrjes nga banesa për secilën prej familjet e kërkuesve. Kërkuesit nuk argumentuan se ato mjete do të kishin qenë "efikase" në praktikë, si edhe ligjërisht, veçanërisht në kuptimin se ushtrimi i tyre do të pengohej në mënyrë të pajustifikueshme nga veprimet ose mosveprimet e autoriteteve të Shtetit të paditur (shih midis vendimeve të tjera edhe *Aksoy kundër Turqisë*, 18 dhjetor 1996, f. 2286 § 95, *Raportet e vendimeve dhe gjykimeve* 1996–VI dhe të krahasohet dhe të bëhet dallimi me *Ramadhi dhe të Tjerët kundër Shqipërisë*, nr. 38222/02, §§ 45–53, 13 nëntor 2007 dhe *Luli dhe të Tjerët kundër Shqipërisë* (nr. 64480/09 dhe 5 të tjerë, §§ 77–84, dhe §§ 114–119, 1 prill 2014). Në këto rrethana, Gjykata merr në konsideratë faktin se ekzistonte, ende, të paktën një mjet efikas në nivel të brendshëm, të cilin mund ta kishin përdorur kërkuesit, më konkretisht, një veprim përpara gjykatës së rrethit me mundësinë për një apel në Gjykatën e Lartë. Veçanërisht sipas faktit se Konventa është drejtpërdrejtë e zbatueshme në Shqipëri, sipas Nenit 122 § 1 të Kushtetutës, një apelim përpara gjykatave vendëse, do t'u kishte dhënë atyre mundësinë të vlerësonin proporcionalitetin e zbatimit të aktit normativ 2012 në secilin prej çështjeve të kërkuesve. Gjykata thekson se prania e dyshimeve në lidhje me mundësitë për suksesin e një mjeti specifik, i cili është dukshëm i pavlerë, nuk është një arsye e vlefshme për mosshterimin e asaj forme korrigjimi (shih *Vučković*, cituar më sipër, § 74). Gjykata nuk mund të shqyrtojë situatat individuale të kërkuesve konkret, në rast se kërkuesit nuk kanë përdorur mjetet e disponueshme në nivel të brendshëm. Gjykata vëren se i vetmi veprim ligjor që kanë ndërmarrë kërkuesit në nivel të brendshëm ishte një peticion në Këshillin e Ministrave, çka nuk është një mjet efikas sipas Konventës.

4. Përfundim

81. Për sa më sipër dhe në lidhje me rrethanat e çështjeve, Gjykata nuk konstaton se ka pasur arsye të veçanta për të përjashtuar kërkuesit nga kërkesa për shterimin e mjeteve vendëse në përputhje me ligjin vendës. Përkundrazi, nëse kërkuesit do të kishin rënë dakord me këtë kërkesë, gjykatat vendëse do të kishin përfituar mundësinë, për të cilën është parashikuar vendimi për shfrytëzimin e mjeteve vendëse në mbështetjeje të shteteve, më konkretisht: përcaktimi i çështjes së përputhshmërisë së masave kombëtare të kundërshtuara, ose i mosveprimeve, sipas Konventës; dhe nëse kërkuesit do ta kishin ndjekur ankesën e tyre në Gjykatën Evropiane, kjo Gjykatë do të kishte përfituar opinionet e gjykatave kombëtare (shih, midis vendimeve të tjera, *Van Oosterwijck kundër*

Belgjikës, 6 nëntor 1980, § 34, seritë A nr. 40, dhe *Burden kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], nr. 13378/05, § 42, GJEDNJ 2008). Në këtë mënyrë, kërkuesit nuk ndërmorën hapat e duhur për t'iu mundësuar gjykatave vendëse të përmbushnin rolin e tyre themelor në sistemin e mbrojtjes së Konventës, faktin se Gjykata Evropiane ishte nën varësinë e gjykatës së tyre (shih *Burden*, cituar më sipër, § 42, dhe *Akdivar dhe të Tjerët kundër Turqisë*, 16 shtator 1996, §§ 65 f. 66, raporte të gjykimeve dhe vendimeve 1996 f. IV).

82. Sipas rrethanave, ankesat e kërkuesve, mbështetur në nenin 8 të Konventës, duhet të rrëzohen sipas nenit 35 § 1 dhe 4 të Konventës për mosshterim të mjeteve vendëse.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime,

Vendos të bashkojë kërkesat;

I deklaron kërkesat të papranueshme.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 17 maj 2018.

Stanley Naismith REGJISTRUES — **Robert Spano** KRYETAR

SHTOJCË
SHTOJCA 1

Nr.	Kërkesa nr.	Dorëzuar më	Emri i kërkuesit dhe datëlindja	Statusi ekonomik i kërkuesit	Urdhri për nxjerrjen nga banesa	Urdhri përmbarimor	Informacione të tjera
1.	43928/13	30.4.2013	**Eglantina BAKIU** 27.7.1959	E punësuar, fiton 390 euro në muaj	Urdhri për nxjerrjen nga banesa i EKB-së, i datës 15.11.2012	Vendim i Gjykatës së Rrethit i datës 23.11.2012	Shkresa e përmbaruesit e datës 27.12.2012, për të respektuar vullnetarisht urdhrin përmbarimor
			Ilir BAKIU 15.2.1967	Me banim në Itali. Nuk ka informacion që prej kohës kur			
			Vezire BAKIU 5.2.1935	Në pension			
2.	43934/13	30.4.2013	**Fatbardh TOQI** 26.9.1969	I punësuar, fiton 360 euro në muaj	Urdhri për nxjerrjen nga banesa i EKB-së, i datës 7.11.2012	Vendim i Gjykatës së Rrethit i datës 21.11.2012	Familje, e cila jeton në apartament që prej vitit 1974
			Evis TOQI 17.4.1976	I punësuar, fiton 330 euro në muaj			
			Nimet ALLUSHI 28.9.1945	Në pension			
3.	44107/13	30.4.2013	**Fire BATKU** 9.12.1946	Në pension, merr 55 euro në muaj	Urdhri për nxjerrjen nga banesa i EKB-së, i datës 15.11.2012	Vendim i Gjykatës së Rrethit i datës 4.2.2013	Shkresa e përmbaruesit e datës 27.12.2012, për të respektuar vullnetarisht urdhrin përmbarimor.
			Julian BATKU 9.12.1946	I punësuar			
			Suela BATKU 17.10.1975	E papunë			

4.	44132/13	30.4.2013	**Nikolina KOVAÇI** 7.12.1942	Në pension, merr 100 euro në muaj	Urdhri për nxjerrjen nga banesa i EKB-së, i datës 8.11.2012	Vendim i Gjykatës së Rrethit i datës 21.11.2012	
5.	44136/13	30.4.2013	**Gjyze META** 5.3.1937	Në pension	Urdhri për nxjerrjen nga banesa i EKB-së, i datës 26.12.2012	Vendim i Gjykatës së Rrethit i datës 22.1.2013	
6.	44140/13	30.4.2013	**Daniela NIKOLLA** 16.12.1964	Merr ndihmë financiare për aftësi të kufizuara	Urdhri për nxjerrjen nga banesa i EKB-së, i datës 23.11.2012	Vendim i Gjykatës së Rrethit i datës 4.12.2012	
7.	44147/13	30.4.2013	**Foto XHILLARI** 3.5.1923	Në pension, merr 115 euro në muaj	Urdhri për nxjerrjen nga banesa i EKB-së, i datës 18.1.2013	Vendim i Gjykatës së Rrethit i datës 29.1.2013	
8.	44150/13	30.4.2013	**Gezim VINÇANI** 22.5.1956	Nuk ka informacion	Urdhri për nxjerrjen nga banesa i EKB-së, i datës 7.11.2012	Vendim i Gjykatës së Rrethit i datës 20.11.2012	
9.	44152/13	30.4.2013	**Bujar SUBASHI** 16.10.1962 Tirana	I punësuar, fiton 225 euro në muaj	Urdhri për nxjerrjen nga banesa i EKB-së, i datës 27.11.2012	Vendim i Gjykatës së Rrethit i datës 10.12.2012	Familje, e cila jeton në një apartament që prej vitit 1959.
			Anila SUBASHI 30.9.1968	E papunë, ndihmë financiare 50 euro në muaj			
10.	44153/13	30.4.2013	**Sabrije SUBASHI** 19.5.1927	Në pension	Urdhri për nxjerrjen nga banesa i EKB-së, i datës 27.11.2012	Vendim i Gjykatës së Rrethit i datës 10.12.2012	Familje, e cila jeton në një apartament që prej vitit 1959.
			Ilirjan SUBASHI 1.8.1953	I papunë, ndihmë financiare 130 euro së bashku me bashkëshorten e tij			

			Kreshnik SUBASHI 11.7.1983	Student			
			Drini SUBASHI 27.10.1985	I punësuar, fiton 708 euro në muaj			
			Nexhmije SUBASHI 21.5.1960	E papunë			
11.	44522/13	30.4.2013	**Burhan SPAHIU** 5.1.1943	Në pension, merr 165 euro në muaj, nuk ka pronë	Urdhri për nxjerrjen nga banesa i EKB-së, i datës 7.1.2012	Vendim i Gjykatës së Rrethit i datës 21.11.2012	Familje, e cila jeton në një apartament që prej vitit 1991. Shkresa e përmbaruesit e datës 5.2.2013, për të respektuar vullnetarisht urdhrin përmbarimor
			Dorjan SPAHIU 15.3.1969	I papunë			
12.	44526/13	30.4.2013	**Bukurosh RECI** 11.7.1954	I papunë që prej vitit 2015.	Urdhri për nxjerrjen nga banesa i EKB-së, i datës 15.11.2012	Vendim i Gjykatës së Rrethit i datës 27.11.2012	Familje, e cila jeton në një apartament që prej vitit 1945.
13.	44535/13	30.4.2013	**Ermira PAJA** 29.7.1959	I punësuar, fiton 289 euro në muaj	Urdhri për nxjerrjen nga banesa i EKB-së, i datës 23.1.2012	Vendim i Gjykatës së Rrethit i datës 4.12.2012	Familje, e cila jeton në një apartament që prej vitit 1988.
14.	44542/13	30.4.2013	**Lulzim DHIMITRI** 22.4.1952	I papunë që prej muajit shkurt 2014. Më parë i punësuar, fitonte 290 euro në muaj	Urdhri për nxjerrjen nga banesa i EKB-së, i datës 8.11.2012	Vendim i Gjykatës së Rrethit i datës 4.12.2012	Familje, e cila jeton në një apartament që prej vitit 1948.
			Bukurie DHIMITRI 5.11.1956	Pension për aftësi të kufizuar – 151 euro + 22 euro përfitime			
15.	44548/13	30.4.2013	**Brahim FIKAJ** 26.7.1944	Në pension, merr 167 euro në muaj	Urdhri për nxjerrjen nga banesa i EKB-së, i	Vendim i Gjykatës së Rrethit i datës 29.1.2013	Familje, e cila jeton në një apartament që prej vitit 1973.

			Lirije FIKAJ 29.8.1949	Në pension, merr 105 euro në muaj	datës 1.3.2012		
			Brunilda FIKAJ 18.7.1982	E papunë. Paga e mëparshme – 254 euro			
16.	44611/13	30.4.2013	**Vladimir DHIMITRI** 19.1.1949	I punësuar, fiton 340 euro në muaj	Urdhri për nxjerrjen nga banesa i EKB-së, i datës 8.11.2012	Vendim i Gjykatës së Rrethit i datës 4.12.2012	Familje, e cila jeton në një apartament që prej vitit 1948.
			Tania DHIMITRI 16.2.1952	Në pension, merr 162 euro në muaj			
			Olta DHIMITRI 28.3.1985	E punësuar, fiton 175 euro në muaj; nuk ka pronë; nuk ka informacione të tjera.			
17.	44632/13	30.4.2013	**Fadile KADAREJA** 13.2.1958	E papunë.	Urdhri për nxjerrjen nga banesa i EKB-së, i datës 18.1.2013	Vendim i Gjykatës së Rrethit i datës 29.1.2013.	Familje, e cila jeton në një apartament që prej vitit 1963.
			Besnik KADAREJA 18.6.1954	I punësuar, fiton 220 euro në muaj.			

SHTOJCA 2
(INFORMACIONE FAKTIKE)

Nr.	**Kërkesa nr.**	**Dorëzuar më**	**Emri i kërkuesit dhe datëlindja**	**Përmasa e banesës Vlera e përllogaritur e banesës Vendndodhja e banesës Qiraja mujore e paguar Qiraja mujore e tregut Fitimet mujore**	**Nëse është zbatuar urdhri për nxjerrjen nga banesa Strehimi aktual (informacioni më i fundit) Si synojnë të gjejnë strehim afatgjatë**
1.	43928/13	30.4.2013	**Eglantina BAKIU** 27.7.1959	Fitimet mujore – 474 euro	Kërkuesit u nxorën nga banesa më 30 janar 2013 (është dorëzuar dokumenti). Që prej vitit 1994, ata kanë dorëzuar shumë kërkesa pranë EKB-së dhe Bashkisë Tiranë për strehim alternativ. Pas nxjerrjes nga banesa, mbesa e kërkuesve (e cila nuk është pjesëtarë e familjes) mori një hua në emër të familjes Bakiu, duke qenë se anëtarët e familjes
			Ilir BAKIU 15.2.1967		
			Vezire BAKIU 5.2.1935		

					nuk i përmbushnin kriteret për hua. U ble një apartament me sipërfaqe 102.42 m^2, i gjendur në Yzberisht, për 46,560 euro, me hua. Shlyerja mujore e huas: 108 euro. Nuk ka pronë tjetër.
2.	43934/13	30.4.2013	**Fatbardh TOQI** 26.9.1969 **Evis TOQI** 17.4.1976 **Nimet ALLUSHI** 28.9.1945	Nuk është dhënë informacion.	Nuk është dhënë informacion.
3.	44107/13	30.4.2013	**Fire BATKU** 9.12.1946 **Julian BATKU** 9.12.1946 **Suela BATKU** 17.10.1975	Nuk është dhënë informacion.	Nuk është dhënë informacion.
4.	44132/13	30.4.2013	**Nikolina KOVAÇI** 7.12.1942	Nuk është dhënë informacion.	Nuk është dhënë informacion.
5.	44136/13	30.4.2013	**Gjyze META** 5.3.1937	Nuk është dhënë informacion.	Nuk është dhënë informacion.
6.	44140/13	30.4.2013	**Daniela NIKOLLA** 16.12.1964	Nuk është dhënë informacion.	Nuk është dhënë informacion.
7.	44147/13	30.4.2013	**Foto XHILLARI** 3.5.1923	Nuk është dhënë informacion.	Nuk është dhënë informacion.
8.	44150/13	30.4.2013	**Gezim VINÇANI** 22.5.1956	Nuk është dhënë informacion.	Nuk është dhënë informacion.
9.	44152/13	30.4.2013	**Bujar SUBASHI** 16.10.1962 Tirana **Anila SUBASHI** 30.9.1968	82 metër katrorë në Rrugën 6 Faik Ternova, në qendër të Tiranës – aty jetonin dy familje. Vlera e përllogaritur në vitin 1994 – 5,797 euro Qiraja mujore e paguar përpara privatizimit – 0.22	Kërkuesit e nxjerrë nga banesë në mars 2013. Nuk janë ndërmarrë hapa për strehim alternativ, pritej fjala e autoriteteve sipas ligjit në fuqi. Megjithatë, dokumentet janë dorëzuar disa herë në Bashkinë

				euro (22 cent) Qiraja mujore e paguar pas privatizimit – 1.10 euro Qiraja mujore e tregut – 123 euro Fitimet mujore – 217 euro (1992 deri më sot) Banesa është mirëmbajtur dhe në të janë bërë investime të konsiderueshme.	Tiranë. Miratohet kërkesa për hua me interes zero. Megjithatë, ka pasur vështirësi në përdorimin e huas që prej dhënies së saj, duke marrë në konsideratë statusin e tij civil kur ishte i pamartuar. Tani, familja përbëhet nga pesë persona. Huaja është dhënë për një banesë me sipërfaqe prej 40 metër katrorë. Aktualisht, kërkuesi së bashku me nënën e tij jetojnë në një dhomë të marrë me qira me sipërfaqe prej 17 metër katrorë. Dhoma pozicionohet larg prej qendrës së Tiranës dhe ai ka vështirësi në shlyerjen e qirasë. Bashkëshortja dhe fëmijët e tij jetojnë me vjehrrin dhe vjehrrën e tij. Kërkuesi ankohet se ka vështirësi në shlyerjen e qirasë dhe kërkon nga Shteti strehim afatgjatë.
10.	44153/13	30.4.2013	**Sabrije SUBASHI** 19.5.1927 **Ilirjan SUBASHI** 1.8.1953 **Kreshnik SUBASHI** 11.7.1983 **Drini SUBASHI** 27.10.1985 **Nexhmije SUBASHI** 21.5.1960	82 metër katrorë në Rrugën 6 Faik Ternova, në qendër të Tiranës – aty jetonin dy familje. Vlera e përllogaritur në vitin 1994 – 5,797 euro Qiraja mujore e paguar përpara privatizimit – 0.22 euro (22 centë) Qiraja mujore e paguar pas privatizimit – 1.1 euro Fitimet mujore – 217 euro (1992–2013) Banesa është mirëmbajtur dhe në të janë bërë investime të konsiderueshme.	Kërkuesit janë nxjerrë nga banesa në mars 2013. Nuk janë ndërmarrë hapa për strehim alternativ, pritej fjala e autoriteteve sipas ligjit në fuqi. Megjithatë, dokumentet janë dorëzuar disa herë në Bashkinë Tiranë. Aktualisht, familja jeton në një apartament me sipërfaqe prej 98 metër katrorë në Tufinë, Tiranë. Iu është dhënë një hua prej 31,665 eurosh nga Bashkia. Duke qenë se huaja nuk mbulonte kostot e apartamentit, ai u detyrua të kërkonte ndihmën e të afërmve të tij për të marrë një hua tjetër nga banka. Shlyerja mujore e huas për

					t'iu paguar bashkisë është 88 euro për një periudhë prej 360 muaj. Interesi mbi huan është 36 euro në muaj. Shlyerja mujore e huas për bankën tjetër është 167 euro për një periudhë prej gjashtëdhjetë muajsh. Kërkuesi ankohet se ai dhe bashkëshortja kanë të ardhura shumë të ulëta.
11.	44522/13	30.4.2013	**Burhan SPAHIU** 5.1.1943 **Dorjan SPAHIU** 15.3.1969	Nuk është dhënë informacion.	Nuk është dhënë informacion.
12.	44526/13	30.4.2013	**Bukurosh RECI** 11.7.1954	56 metër katrorë në qendër të Tiranës. Vlera e tregut – 1000 euro/metër katrorë	Nxjerrë nga banesa më 30 janar 2013 (është dorëzuar dokumenti). Nuk është kualifikuar asnjëherë për strehim social ose për të blerë një pronë e cila më herët ka qenë në pronësinë e shtetit. Aktualisht jeton në një apartament me sipërfaqe 50 metër katrorë dhe paguan 116 euro qira mujore. Huaja e dhënë nga Banka është e pavlefshme përderisa ai nuk mund ta shlyejë atë. Ai parashtron se nuk ka mjete financiare ta shlyejë huan.
13.	44535/13	30.4.2013	**Ermira PAJA** 29.7.1959	80 metër katrorë pozicionuar në qendër të Tiranës. Vlera e tregut – 870 euro/metër katrorë.	Nxjerrë nga banesa më 12 shkurt 2013 (është paraqitur dokumenti). Për pothuajse dy vjet ka jetuar në një rezidencë për familjarë. Në mars të vitit 2014, ai aplikoi për hua – të dhënë nga Banka. Aktualisht, jeton në një apartament me sipërfaqe 80 metër katrorë në periferi të Tiranës. Vlera e tregut – 217

					euro/metër katrorë. Shlyerja mujore e huas – 85 euro. Kërkuesi ankohet se ka shumë shpenzime për shkak të huas dhe mirëmbajtjes së apartamentit të ri dhe se dhënia a huas nuk është zgjidhje për problemin e saj të strehimit dhe se Shteti duhet të mbulojë koston e të gjithë huas, jo vetëm interesin.
14.	44542/13	30.4.2013	**Lulzim DHIMITRI** 22.4.1952 **Bukurie DHIMITRI** 5.11.1956	110 metër katrorë.	Nxjerrë nga banesa më 30 janar 2013. Përpara se të nxirrej nga banesa, kërkuesi kishte aplikuar për strehim social, por nga autoritetet nuk kishte ardhur asnjë përgjigje. Nuk mundet të përmbushë kërkesat për marrjen e një huaje. 75 metër katrorë; jeton në të njëjtën zonë, si edhe përpara nxjerrjes nga banesa. Kërkuesi ankohet se apartamenti ndodhet në katin e pestë, çka e bën të vështirë jetesën në atë vend për gruan e tij me aftësi të kufizuara. Qiraja mujore e paguar – 181 euro. Qiraja mesatare – 254 euro.
15.	44548/13	30.4.2013	**Brahim FIKAJ** 26.7.1944 **Lirije FIKAJ** 29.8.1949 **Brunilda FIKAJ** 18.7.1982	76 metër katrorë Mirëmbajtja dhe shpenzime të tjera të konsiderueshme Vlera e tregut – 1,000-1,500 euro/metër katrorë.	Nxjerrë nga banesa më 17 korrik 2013. Dorëzimi i dokumenteve në Bashkinë e Tiranës, dhe në departamentet e saj përbërës dhe EKB-së. Nuk është dhënë hua, sepse ata nuk mund të përmbushnin kërkesat e Bankës për të marrë një hua. Përgjigje negative për strehim social, sepse të ardhurat e tyre janë mbi

					limitin. Në vitin 2015, EKB-ja u përgjigj se Bashkia ishte e detyruar të gjende strehim për ta. Përsëri, Bashkia dha përgjigje negative, sepse të ardhurat e tyre ishin mbi limit. Aktualisht, ata kanë me qira një apartament me sipërfaqe 54 metër katrorë me qira 145 euro në muaj. Kërkuesit ankohen se familja nuk ka mundësi të gjej strehim afatgjatë e të ardhurat e tyre dhe çmimet e tregut për apartamente. Ata kërkojnë kompensim, në mënyrë që familja të mund të blejë një apartament ose që Shteti t'i garantojë atyre strehim.
16.	44611/13	30.4.2013	**Vladimir DHIMITRI** 19.1.1949 **Tania DHIMITRI** 16.2.1952 **Olta DHIMITRI** 28.3.1985	Nuk është dhënë informacion.	Nuk është dhënë informacion.
17.	44632/13	30.4.2013	**Fadile KADAREJA** 13.2.1958		Ka marrë një hua, por nuk mund ta paguajë atë për shkak të mungesës së mjeteve financiare. Jeton në një apartament me sipërfaqe 64 metër katrorë në Yzberisht. Apartamenti u ble me hua. Kërkuesi kërkon që Shteti të paguajë të gjithë huan.

VENDIM
Nr. 60, datë 6.9.2018

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR NDRYSHIMIN E TARIFAVE TË SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME DELVINË

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a dhe të nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 63, datë 27.1.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura"; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015, "Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura"; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12 2015, "Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura"; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015, "Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura" dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura", Komisioni Kombëtar Rregullator, në mbledhjen e tij të datës 6.9.2018, pasi shqyrtoi relacionin mbi aplikimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Delvinë, përgatitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike,

konstatoi se:

ERRU-ja, në përmbushje të përgjegjësive ligjore, konkretisht nenit 14, nenit 22 dhe nenit 33, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, miraton tarifat e shërbimeve ujësjellës-kanalizime, në mënyrë që të sigurojë konsumatorët që ofruesit e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të japin cilësinë më të mirë të mundshme, me një çmim të arsyeshëm dhe në një mënyrë të qëndrueshme financiarisht.

Bazuar në pikën 3, të kreut II, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 63, datë 27.1.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Delvinë është licencuar me vendimin e KKRR-së nr. 14, datë 28.4.2017, "Për licencimin e Ujësjellës-Kanalizimeve Delvinë", pas përfundimit të riorganizimit sipas ndarjes së re territoriale.

Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Delvinë ka aplikuar pranë ERRU-së, me shkresën nr. 106 prot., datë 29.5.2018, me lëndë: "Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizime", bazuar në vlerësimin e situatës ekonomike-financiare dhe nevojën për përmirësimin e saj pas riorganizimit sipas reformës administrativo-territoriale. Nga kontrolli formal i dokumentacionit aplikimit i mungonte "vendimi i Këshillit Bashkiak Delvinë", dokument i cili u plotësua me shkresën nr. 148 prot., datë 26.7.2018.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Delvinë për nivelin e ri të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizime.

2. Drejtoria Tekniko-Ekonomike detyrohet të njoftojë shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Delvinë për vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 61, datë 6.9.2018

PËR MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE NDAJ SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME DIBËR SHA

Në mbështetje të germës "h", të pikës 1, të nenit 14, dhe të nenit 32/1 pika a/b, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010, "Për kundërvajtjet administrative" dhe rregullores së inspektimit të miratuar me vendim të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 58, datë 29.12.2017, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Dibër sh.a. dënohet me gjobë në shumën 100 000 (njëqind mijë) lekë për moszbatim të tarifave të ERRU-së për tarifat.

2. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Dibër sh.a. dënohet me gjobë në shumën 100 000 (njëqind mijë) lekë për mospagimin e detyrimeve financiare ndaj entit rregullator, brenda afateve kohore të përcaktuara nga ky institucion.

3. Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit ngarkohet të njoftojë Shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Dibër sh.a. për vendimin e marrë nga Komisioni Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatë, brenda 30 ditëve nga marrja dijeni mbi vendimin.

KRYETARI
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 62, datë 6.9.2018

PËR LICENCIMIN E UJËSJELLËS-KANALIZIME SHA SARANDË

Në zbatim të nenit 14, pika 1/a, të nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura"; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë", si dhe rregullores së licencimit miratuar me vendim të KKRR-së nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, dhe pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike, mbi aplikimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime sh.a. Sarandë për licencim për efekt të përfundimit të afatit, Komisioni Kombëtar Rregullator,

konstatoi se:

- Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Sarandë, me NUIS: J64228814D, është licencuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator, me vendimin nr. 40, datë 11.12.2013, "Për rinovim licence sh.a. Ujësjellës-kanalizime Sarandë", e vlefshme deri në datën 13.6.2016.

- Shoqëria, me shkresën nr. 364 prot., të datës 11.7.2018, ka aplikuar pranë ERRU-së për licencim për arsye të përfundimit të afatit të licencës. Me shkresën nr. prot. 375, datë 26.7.2018, janë bërë plotësimet përkatëse në dosjen e aplikimit pas mangësive që kishte.

- Aplikimi i shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime sh.a. Sarandë plotëson kërkesat e parashikuara në rregulloren e licencimit për përfundimin e afatit të licencimit, konkretisht:

- Formati i aplikimit është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik dhe administrativ është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- Ujësjellës-Kanalizime sh.a. Sarandë ofron shërbim edhe në disa fshatra të Bashkisë Finiq deri në përfundim të kalimit faktik të aseteve.

- Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime sh.a. Sarandë detyrohet të njoftojë ERRU-në, pasi të ketë përfunduar procesin e kalimit faktik të aseteve të Bashkisë Finiq.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit Ujësjellës-Kanalizime sh.a. Sarandë, me:

Drejtues ligjor: Sheme Lulo;

Drejtuesit teknik: Eljon Mahmutaj.

2. Operatori Ujësjellës-Kanalizime sh.a. Sarandë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar, në kategoritë:

Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është si më poshtë:

- Bashkia Sarandë;
- Bashkia Finiq (pjesërisht):

Njësia Administrative Finiq, fshati Vrion;

Njësia Administrative Aliko, fshatrat Aliko, Çaush, Neohor, Tremul; Njësia Administrative Dhiver, fshati Navaricë;

Njësia Administrative Mesopotam, fshatrat Livinë, Fitore, Krane, Ardhasovë.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare (katërvjeçare).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 63, datë 6.9.2018

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR NDRYSHIMIN E TARIFAVE TË SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME LUSHNJË SHA

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a dhe të nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 63, datë 27.1.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura"; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015, "Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura"; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, "Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura"; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015, "Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura" dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura", Komisioni Kombëtar Rregullator, në mbledhjen e tij të datës 6.9.2018, pasi shqyrtoi relacionin mbi aplikimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Lushnjë sh.a., përgatitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike,

konstatoi se:

ERRU-ja, në përmbushje të përgjegjësive ligjore, konkretisht të nenit 14, të nenit 22 dhe të nenit 33, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, miraton tarifat e shërbimeve ujësjellës-kanalizime në mënyrë që të sigurojë konsumatorët që ofruesit e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të japin cilësinë më të mirë të mundshme, me një çmim të arsyeshëm dhe në një mënyrë të qëndrueshme financiarisht.

Bazuar në pikën 3, të kreut II, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 63, datë 27.1.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Lushnjë sh.a. është licencuar me vendimin e KKRR-së nr. 40, datë 23.9.2016, "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Lushnjë", pas përfundimit të riorganizimit sipas ndarjes së re territoriale.

Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Lushnjë sh.a. ka aplikuar pranë ERRU-së, me shkresën nr. 700 prot. datë 26.6.2018, me lëndë "Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizime", bazuar në vlerësimin e situatës ekonomike-financiare dhe nevojën për përmirësimin e saj pas riorganizimit sipas reformës administrativo-territoriale. Nga kontrolli formal i dokumentacionit, aplikimit i mungonte "vendimi i Këshillit Bashkiak Lushnjë", dokument i cili u plotësua me shkresë nr. 700/2 prot., datë 26.7.2018.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime

Lushnjë sh.a. për nivelin e ri të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizime.

2. Drejtoria Tekniko-Ekonomike detyrohet të njoftojë shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Lushnjë sh.a. për vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 64, datë 6.9.2018

PËR MOSMARRJEN NË SHQYRTIM TË APLIKIMIT PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA PËR SHOQËRINË UJËSJELLËS-KANALIZIME FIER

Në mbështetje të neneve 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 63, datë 27.1.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë dhe të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura"; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015, "Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura"; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12 2015, "Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura"; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12. 2015, "Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura" dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimin e ujërave të ndotura", pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi aplikimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Fier, për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura, Komisioni Kombëtar Rregullator,

konstatoi se:

- Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Fier është licencuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator, me vendimin nr. 2, datë 22.1.2014, "Për licencimin e Ujësjellës-Kanalizime Fier", me afat vlefshmërie deri në datën 21.1.2018.

- Shoqëria UK Fier, me shkresën nr. 122 prot., datë 31.1.2018, ka aplikuar për rinovimin e licencës, si dhe për zgjerimin e zonës së shërbimit në kuadër të riorganizimit, sipas ndarjes së re territoriale. Në dokumentacionin e dërguar pranë ERRU-së mungon dokumenti "Akt miratimi i lejes higjieno-sanitare", dokument i cili ende nuk është paraqitur nga shoqëria.

- Komisioni Kombëtar Rregullator, në mbledhjen e mëparshme, ka gjykuar që shoqëria UK Fier duhet të plotësojë dokumentin e mësipërm me qëllim vijimin e procedurës për licencimin e saj.

- Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Fier, me shkresë nr. 752 prot., datë 23.10.2017, ka aplikuar për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura, për zonën e re të shërbimit që ka marrë në administrim.

- Dosja e aplikimit, për miratimin e tarifave të reja të propozuara nga shoqëria UK Fier, është paraqitur e plotë sipas standardit të kërkuar nga ERRU-ja për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm.

- Për shqyrtimin e analizës, si dhe vendimmarrjen për tarifat e propozuara nga UK Fier, pengesë mbetet mungesa e rinovimit të licencës së shoqërisë UK Fier edhe për zonën e re të shërbimit.

- Në mbledhjen e datës 6.9.2018, Komisioni Kombëtar Rregullator analizoi dhe një herë situatën e aplikimeve për ndryshimin e tarifave të shoqërive UK. Për shoqërinë UK Fier gjykoi se ka kaluar një periudhë e gjatë që nga momenti i aplikimit, ku shoqëria UK Fier nuk është treguar korrekte me plotësimin e dokumentacionit të kërkuar, me qëllim vijimin e procedurës nga ERRU-ja, për pajisjen me licencë për shërbimet UK, e cila ka frenuar procedurën e mëtejshme të aplikimit për miratimin e tarifave.

Për sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të mos marrë në shqyrtim aplikimin e Shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Fier për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për zonat e reja.

2. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Fier detyrohet të aplikojë për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura, me dokumentacionin dhe të dhënat e plota, pasi licenca për ushtrimin e aktivitetit të jetë miratuar nga KKRR-ja.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 65, datë 6.9.2018

PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME KAVAJË

Në zbatim të nenit 14, pika 1/a, të nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura"; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë", si dhe rregullores së licencimit miratuar me vendim të KKRR-së nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, dhe pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike, mbi aplikimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Kavajë sh.a., për licencim për efekt përfundimit të afatit, Komisioni Kombëtar Rregullator,

konstatoi se:

- Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Kavajë është licencuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator, me vendimin nr. 10, datë 16.3.2015, "Për licencimin sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Kavajë", të ndryshuar.

- Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Kavajë ka aplikuar për licencim pranë ERRU-së, me shkresën nr. 1622 prot., datë 4.6.2018, për efekt të përfundimit të afatit.

- Aplikimi i shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Kavajë sh.a. plotëson kërkesat e parashikuara në rregulloren e licencimit për përfundimin e afatit të licencimit, për kategoritë A, B dhe C, konkretisht:

- Formati i aplikimit është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik dhe administrativ është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Për dokumentin "Ekstrakt Historik i Regjistrit Tregtar", në të cilin ende nuk janë reflektuar ndryshimet sipas riorganizimit të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Kavajë sh.a., bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 63, datë 27.1.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Kavajë detyrohet të paraqesë pranë ERRU-së ekstraktin e QKB-së të përditësuar, menjëherë pas përfundimit të procesit.

- Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Kavajë ende nuk është pajisur me leje të re mjedisore për impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura dhe për këtë arsye nuk mund të licencohet për kategorinë D, "Për trajtimin e ujërave të ndotura".

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Kavajë, me:

Drejtues ligjor: Hajrulla Tafa;

Drejtues teknik: Sali Vogli.

2. Operatori Ujësjellës-Kanalizime sh.a. Sarandë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar, në kategoritë:

Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

Kategoria B: Për përpunimin e ujit për konsum publik;

Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Kavajë.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare (katërvjeçare).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 66, datë 6.9.2018

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 54, DATË 15.12.2017, "PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME KOLONJË"

Në zbatim të nenit 14, pika 1/a, të nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura"; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence", si dhe rregullores së licencimit, miratuar me vendim të KKRR-së nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, dhe pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike, mbi aplikimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Kolonjë sh.a., për licencim për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik, Komisioni Kombëtar Rregullator,

konstatoi se:

- Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Kolonjë është licencuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator, me vendimin nr. 54, datë 15.12.2017, "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Kolonjë";

- Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Kolonjë ka aplikuar me anë të shkresës nr. 251 prot., datë 24.4.2018, për licencim për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik;

- Aplikimi i shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Kolonjë sh.a. plotëson të gjitha kërkesat e parashikuara në rregulloren e licencimit mbi ndryshimin e drejtuesit teknik, konkretisht:

- Dokumentacioni juridik dhe administrativ është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- Drejtuesi teknik plotëson kriteret e parashikuara në rregulloren e licencimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit nr. 54, datë 15.12.2017, "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Kolonjë", bëhen këto ndryshime:

"Drejtues teknik: Robert Hamzai".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 67, datë 6.9.2018

PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME DROPULL

Në zbatim të nenit 14, pika 1/a, të nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë", si dhe rregullores së licencimit miratuar me vendim të KKRR-së nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, dhe pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike, mbi aplikimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Dropull sh.a., për licencim për herë të parë, Komisioni Kombëtar Rregullator,

konstatoi se:

- Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Dropull sh.a. ka aplikuar pranë ERRU-së për licencim për herë të parë, me shkresën me nr. 39 prot., të datës 13.6.2018, për ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura;

- Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Dropull sh.a. është themeluar në datën 21.12.2017, si shoqëri aksionare me një nivel administrimi në pronësi të Bashkisë Dropull, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 63, datë 27.1.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që

ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura". Kjo shoqëri është regjistruar në QKB në datën 16.2.2018, me NUIS: L82616601E;

- Në dosjen e aplikimit mungonte dokumenti i ekstraktit të regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Dropull, si dhe akti i miratimit higjieno-sanitar, si dhe pagesa për licencim për dy kategoritë e kërkuara. Dosja u plotësua në datën 27.7.2018.

- Aplikimi i shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Dropull sh.a. plotëson kërkesat e parashikuara në rregulloren e licencimit për licencim për herë të parë, konkretisht:

- Formati i aplikimit është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik dhe administrativ është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit Ujësjellës-Kanalizime Dropull sh.a., me:

Drejtues ligjor: Alqi Kazazi;

Drejtues teknik: Gaqe Meçi.

2. Operatori Ujësjellës-Kanalizime sh.a. Sarandë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar, në kategoritë:

Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Dropull.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare (katërvjeçare).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR

NË DREJTORINË E SIGURIMIT TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR (DSIK)

Datë 26.92018

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999 "Për informacionin e klasifikuar 'Sekret shtetëror'", i ndryshuar, VKM-së nr. 662, datë 15.11.2017 "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar "Sekret shtetëror", dhe në udhëzimin e drejtorit të DSIK-së nr. 99, datë 13.4.2017 "Për zbatimin e VKM-së nr. 662, datë 15.11.2017 "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar 'Sekret shtetëror', Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvleftësimit të Informacionit të Klasifikuar "Sekret shtetëror" (KDZH) në DSIK, ka deklasifikuar plotësisht disa informacioneve të klasifikuara "Sekret shtetëror" të viteve 2002, 2003, 2004, 2005, 2006 dhe 2007 pasi ju ka mbaruar afati i ruajtjes së klasifikimit.

Informacionet e klasifikuara "Sekret shtetëror" për të cilat u vendos deklasifikimi i plotë i tyre janë si më poshtë:

1. Shkresa nr. 6, datë 16.5.2002 e Ministrisë së Punëve të Jashtme drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Deklaratë kërkesë sigurie", niveli "Konfidencial".

2. Shkresa nr. 19/3 datë 22.7.2003 e DSIK-së, drejtuar MPJ-së, me lëndë: "Kthim përgjigje Tuajës, nr. prot. 112, datë 7.7.2003", niveli "Konfidencial".

3. Shkresa nr. 3, datë 12.9.2002 e DSIK-së drejtuar SHISH-it, me lëndë: "Mbi dërgimin e raportit për inspektimin e masave të marra për zbatimin e kërkesave të vendimit nr. 14, datë 28.1.2002 të Këshillit të Ministrave "Për rregulloren e Shërbimit Shifrar të Republikës së Shqipërisë", niveli "Tepër sekret".

4. Shkresa nr. 230/1, datë 11.9.2002 e DSIK-së, me lëndë: "Program inspektimi".

5. Shkresa nr. 1, datë 11.8.2003 e Ministrisë së Mbrojtjes drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Dërgim praktike", niveli "Konfidencial".

6. Shkresa nr.112 datë 7.7.2003 e MPJ-së drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Kërkohet mendim për vazhdimin e procesit të deklasifikimit për dokumentacionin e viteve 1949–1955, që përmbajnë elemente të kriptologjisë".

7 . Shkresa nr. 15, datë 28.5.2003 e DSIK-së drejtuar SHISH-it, me lëndë: "Program inspektimi", niveli "Tepër sekret".

8. Shkresa nr. 15/1, datë 17.6.2003 e DSIK-së drejtuar SHISH-it, me lëndë: "Mbi dërgimin e raportit për inspektimin e masave të marra për ruajtjen, klasifikimin dhe administrimin e informacionit të klasifikuar 'Sekret shtetëror'", niveli "Tepër sekret".

9. Shkresa nr. 19/1, datë 14.7.2003 e DSIK-së drejtuar SHISH-it, me lëndë: "Kërkohet mendim për vazhdimin e procesit të deklasifikimit për dokumentacionin e viteve 1949–1955, që përmbajnë element të kriptologjisë", niveli "Konfidencial".

10. Shkresa nr. 167, datë 17.7.2003 e SHISH-it (Drejtoria e Shifrës) drejtuar drejtorit të Shërbimit Informativ të Shtetit, me lëndë: "Jepet mendim për deklasifikimin e dokumenteve të transmetuara në shifër", niveli "Konfidencial".

11. Shkresa nr. 1366/1, datë 17.7.2003 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Kthim përgjigje", niveli "Konfidencial".

12. Shkresa nr. 232/3, datë 23.10.2003 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Mbi kontrollin e kryer në Ministrinë e Rendit Publik", niveli "Sekret".

13. Shkresa nr. 12034, datë 27.11.2003 e Ministrisë së Mbrojtjes drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Dërgim projekt-marrëveshje për mendim", niveli "Konfidencial".

14. Shkresa nr. 12035, datë 27.11.2003 e Ministrisë së Mbrojtjes drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Dërgim projekt-marrëveshje për mendim", niveli "Konfidencial".

15. Shkresa nr. 30/1, datë 3.12.2003 e DSIK-së, drejtuar ministrit të Mbrojtjes, me lëndë: "Dërgohet mendim për dy projektmarrëveshje", niveli "Konfidencial".

16. Shkresa nr. 26, datë 18.9.2003 e DSIK-së drejtuar Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, me lëndë: "Për materialin e klasifikuar të NATO-s 'Mbi procedurat protokollare për vizitat në ISAF, Afganistan'", niveli "Konfidencial".

17. Shkresa nr. 103, datë 18.2.2003 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Dërgohet shkresa nr. 2 Action Plan agains terrorisem", niveli "Sekret".

18. Shkresa nr. 1770, datë 24.2.2004 e Ministrisë së Mbrojtjes, drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Dërgohen dy projekt-marrëveshje", niveli "Konfidencial".

19. Shkresa nr. 32/1, datë 25.2.2004 e DSIK-së drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes, me lëndë: "Dërgohet mendim për dy projektmarrëveshje", niveli "Konfidencial".

20. Shkresa nr. 33, datë 11.3.2004 e DSIK-së, drejtuar ministrit të Mbrojtjes, me lëndë: "Dërgohet mendim për dy projektmarrëveshje", niveli "Konfidencial".

21. Shkresa nr. 24, datë 29.3.2004 e Misionit të Republikës së Shqipërisë NATO Bruksel, drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Dokumenti SDIP-31", niveli "I kufizuar".

22. Shkresa nr. 75, datë 31.3.2004 e Ministrisë së Mbrojtjes drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Përgjigje për Shkresën Tuaj nr. 983, datë 9.3.2004", niveli "Sekret".

23. Shkresa nr. 67, datë 17.11.2004 e DSIK-së drejtuar Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, me lëndë: "Dërgohet raporti mbi inspektimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar në SHISH", niveli "Konfidencial".

24. Shkresa nr. 67/2, datë 23.11.2004 e DSIK-së drejtuar Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, me lëndë: "Dërgohet vlerësimi i gjendjes për masat e marra për klasifikimin, deklasifikimin, administrimin dhe qarkullimin e informacionit të klasifikuar 'Sekret shtetëror' në SHISH për Prokurorin e Përgjithshëm të Republikës'", niveli "Konfidencial".

25. Shkresa nr. 67/3, datë 3.12.20004 e DSIK-së drejtuar SHISH-it, me lëndë: "Dërgohet raporti mbi inspektimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar në SHISH", niveli "Konfidencial".

26. Shkresa datë 28.6.2004 e DSIK-së, me lëndë: "Miratohet procesverbal i marrjes në dorëzim të informacionit të klasifikuar 'Sekret shtetëror' të NATO-s që ndodhet në Zyrën e Regjistrit Shtetëror (Qendror)", niveli "Konfidencial".

27. Shkresa nr. 5, datë 16.2.2005 e Ministrisë së Mbrojtjes drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Plan evakuimi", niveli "Konfidencial".

28. Vërtetim lëshuar nga DSIK-ja nr. 70, datë 8.2.2005 për "Gjeneral brigade Arian Zaimi për dorëzimin e informacioneve të klasifikuara të NATO-s, të marra në dorëzim nga Zyra e

Nënregjistrit në Misionin e RSH-së në NATO, Bruksel", niveli "Konfidencial".

29. Shkresa nr. 75, datë 11.2.2005 e DSIK-së drejtuar SHISH-it, me lëndë: "Kërkohet mendim për vazhdimin e procesit të deklasifikimit për dokumentacionin e viteve 1956–1965, që përmbajnë elementë të kriptologjisë", niveli "Konfidencial".

30. Shkresa nr. 188/1, datë 23.2.2005 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Përgjigje për deklasifikimin e materialeve që ndodhen në MPJ", niveli "Konfidencial".

31. Shkresa nr. 28/1, datë 17.2.2005 e MPJ-së drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Përcillen materiale", niveli "Konfidencial".

32. Shkresa nr. 195, datë 18.2.2005 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Mbi cenimin e sigurisë në Drejtorinë e SHISH-it Fier", niveli "Konfidencial".

33. Shkresa nr. 80/1, datë 16.3.2005 e DSIK-së drejtuar SHISH-it, me lëndë: "Kthehet përgjigje për Shkresën Tuaj nr. 195, datë 18.2.2005", niveli "Konfidencial".

34. Shkresa nr. 158, datë 6.4.2005 e Ministrisë së Mbrojtjes drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Draft memorandum për marrëveshje", niveli "Sekret".

35. Shkresa nr. 88, datë 11.4.2005 e DSIK-së drejtuar SHISH-it, me lëndë: "Kthim shkrese", niveli "Sekret".

36. Shkresa nr. 90, datë 13.4.2005 e DSIK-së drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes, me lëndë: "Dërgohet mendim për një projektmarrëveshje", niveli "Sekret".

37. Shkresa nr. 17/1, datë 20.4.2005 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Dërgohet kopje përmbledhëses me akte ligjore dhe nënligjore", niveli "Sekret".

38. Shkresa nr. 96/1 datë 9.6.2005 e DSIK-së drejtuar drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, me lëndë: "Kërkesë për verifikimin e pastërtisë së figurës", niveli "Konfidencial".

39. Shkresa nr. 962, datë 25.8.2005 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Kërkesë për pajisje me certifikatë sigurie për NATO-n", niveli "Sekret".

40. Shkresa nr. 961, datë 25.8.2005 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Kërkesë për pajisje me certifikatë sigurie për NATO-n", niveli "Sekret".

41. Shkresa nr. 960, datë 25.8.2005 e SHISH-it drejtuar DSIKme lëndë: "Kërkesë për pajisje me certifikatë sigurie për NATO-n", niveli "Sekret".

42. Shkresa nr. 1091, datë 26.9.2005 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Kërkesë për shtyrjen e afatit të përdorimit të PGP", niveli "Sekret".

43. Shkresa nr. 106/1, datë 27.9.2005 e DSIK-së drejtuar SHISH-it, me lëndë: "Dërgohet certifikata e sigurisë së PGP", niveli "Tepër sekret".

44. Shkresa nr. 96/3 datë 13.10.2005 e DSIK-së, drejtuar ministrit të Mbrojtjes, me lëndë: "Refuzohet pajisja me certifikatë sigurie të një aplikanti", niveli "Konfidencial".

45. Shkresa nr. 1421, datë 15.11.2005 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Kërkohet autorizim për inspektimin e Organit Qendror Shifrar të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Brendshme", niveli "Sekret".

46. Shkresa e DSIK-së nr. 110/1, datë 16.11.2005 drejtuar SHISH-it, me lëndë: "Lëshim autorizimi", niveli "Sekret".

47. Autorizim i DSIK-së nr. 110/2, datë 16.11.2005 "Për ushtrim kontrolli nga punonjës së Drejtorisë së Shifrës të SHISH-it".

48. Shkresa nr. 2, datë 10.10.2005 e Ministrisë së Mbrojtjes drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Dërgim praktike", niveli "Konfidencial".

49. Shkresa nr. 276, datë 8.3.2005 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Dërgohet informacioni me titull aktivitetet aktuale të shërbimeve sekrete serbe, malazeze dhe ruse ndaj Shqipërisë", niveli "Sekret".

50. Shkresa nr. 83/1, datë 18.3.2005 e DSIK-së drejtuar ambasadorit të Republikës së Shqipërisë në NATO, me lëndë: "Dërgohet dokumenti i klasifikuar aktivitetet aktuale të shërbimeve sekrete serbe, malazeze dhe ruse ndaj Shqipërisë", niveli "Sekret".

51. Shkresa nr. 120, datë 13.2.2006 e DSIK-së drejtuar SHISH-it, me lëndë: "Për dezinfektimin elektronik të sistemit të Zyrave të Informacionit të Klasifikuar të NATO-s në ministri dhe institucione shtetërore", niveli "Konfidencial".

52. Shkresa nr. 307/1, datë 20.2.2006 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Dërgohet raport për dezinfektimin elektronik", niveli "Sekret".

53. Shkresa nr. 68/1, datë 31.3.2006 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Për pajisjen me

certifikatë sigurie për një aplikant" në nivelin "Tepër sekret".

54. Shkresa nr. 125/1, datë 12.4.2006 e DSIK-së drejtuar SHISH-it, me lëndë: "Për pajisjen me certifikatë sigurie për një aplikant", në nivelin "Sekret".

55. Shkresa nr. 68/3, datë 25.4.2006 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Për pajisjen me certifikatë sigurie për një aplikant", në nivelin "Sekret".

56. Shkresa nr. 126/1, datë 11.4.2006 e DSIK-së drejtuar SHISH-it, me lëndë: "Për marrëveshjen për sigurimin e informacionit të klasifikuar me Bullgarinë", niveli "Sekret".

57. Shkresa nr. 1506, datë 15.6.2006 e Misionit të Republikës së Shqipërisë pranë NATO-s Bruksel drejtuar DSIK-së, me lëndë:" Dërgohet informacion "Konfidencial" mbi rrezikun terrorist në Ballkan", niveli "Konfidencial".

58. Shkresa nr. 132 datë 16.6.2006 e DSIK-së, drejtuar ministrit të Brendshëm, me lëndë: "Kërkohet konfirmimi për gjendjen fizike të dokumentit të klasifikuar të NATO-s me reference: DPP (2006)0016 (PFP-ALB)", niveli "Konfidencial".

59. Shkresa nr. 220, datë 4.8.2006 e MPJ-së drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Informacion në lidhje me masat e marra për zbatimin e detyrimeve ligjore në fushën e informacionit të klasifikuar "Sekret" shtetëror"", niveli "Konfidencial".

60. Shkresa nr. 142, datë 12.9.2006 e DSIK-së drejtuar kryetares së Kuvendit, me lëndë: "Kërkohet kthimi i dokumentit të klasifikuar të NATO-s me referencë: "NOS/15(2006)0018"", niveli "I kufizuar".

61. Shkresa nr. 151, datë 1.12.2006 e DSIK-së drejtuar MPJ-së, me lëndë: "Për sigurimin e informacionit të klasifikuar të NATO-s", niveli "I kufizuar".

62. Shkresa e DSIK-së nr. 131, datë 16.6.2006, drejtuar kryetares së Kuvendit, me lëndë: "Kërkohet kthimi i dokumentit të klasifikuar të NATO-s me referencë: NOS/15(2006)0018", niveli "Konfidencial".

63. Shkresa nr. 141, datë 12.9.2006 e DSIK-së, drejtuar ministrit të Brendshëm, me lëndë: "Kërkohet konfirmim për gjendjen fizike të dokumentit të klasifikuar të NATO-s me referencë: DPP(2006)0016(PFP-ALB)", niveli "I kufizuar".

64. Shkresa nr. 4, datë 20.10.2006 e Ministrisë së Mbrojtjes drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Dërgim i dokumentit të PARP-it 2007", niveli "I kufizuar".

65. Shkresa nr. 145/1, datë 20.10.2006 e DSIK-së drejtuar ambasadorit të Republikës së Shqipërisë në NATO, me lëndë: "Dërgohet dokumenti i klasifikuar 'Dokumenti i PARP-it'", niveli "I kufizuar".

66. Shkresa nr. 146, datë 27.10.2006 e DSIK-së drejtuar ambasadorit të Republikës së Shqipërisë në NATO, me lëndë: "Grafik testimi për sistemin Pem-Heart, telefonin e kriptuar 9600 dhe faksin ricoh SFX80M", niveli "I kufizuar".

67. Shkresa nr. 144/1, datë 20.10.2006 e DSIK-së drejtuar ambasadorit të Republikës së Shqipërisë në NATO Bruksel, me lëndë: "Dërgohet dokumenti i klasifikuar 'Dokumenti i PARP-it'", niveli "I kufizuar".

68. Shkresa nr. 1 datë 2.5.2007 e Ministrisë së Mbrojtjes drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Dërgohet informacion për aktivitet spiunazhi ndaj FA-së nga përfaqësues ushtarakë rusë në Shqipëri".

69. Shkresa nr. 166, datë 23.2.2007 e DSIK-së drejtuar ambasadorit të Republikës së Shqipërisë në NATO Bruksel, me lëndë: "Dërgohet dokumenti i klasifikuar "Dokumenti i PARP-it"", niveli "I kufizuar".

70. Shkresa nr. 167, datë 9.3.2007 e DSIK-së drejtuar Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, me lëndë: "Dërgohet informacion paraprak mbi inspektimin e Zyrës së Sigurisë së NATO-s (NOS)", niveli "I kufizuar".

71. Shkresa nr. 168, datë 12.3.2007 e DSIK-së drejtuar MPJ-së, me lëndë: "Dërgohet informacion paraprak mbi inspektimin e Zyrës së Sigurisë së NATO-s (NOS)", niveli "I kufizuar" .

72. Shkresa nr. 169, datë 13.3.2007 e DSIK-së, drejtuar ministrit të Mbrojtjes, me lëndë: "Dërgohet informacion paraprak mbi inspektimin e Zyrës së Sigurisë së NATO-s (NOS)", niveli "I kufizuar".

73. Shkresa nr. 174, datë 2.4.2007 e DSIK-së drejtuar ambasadorit të Republikës së Shqipërisë në NATO Bruksel, me lëndë: "Dërgohet dokumenti i klasifikuar 'Threat factors and elements to the security situation in Kosovo'", niveli "Sekret".

74. Shkresa nr. 181, datë 17.4.2007 e DSIK-së, drejtuar ministrit të Financave, me lëndë: "Për plotësimin e standardeve të sigurisë së informacionit të klasifikuar "Sekret shtetëror"

kombëtar dhe të NATO-s në Ministrinë e Financave", niveli "I kufizuar".

75. Shkresa nr. 183, datë 19.4.2007 e DSIK-së drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë, me lëndë: "Dërgohet një informacion mbi inspektimin e Zyrës së Sigurisë së NATO-s (NOS)", niveli "I kufizuar".

76. Shkresa nr. 188/1, datë 22.5.2007 e DSIK-së drejtuar ambasadorit të Republikës së Shqipërisë në NATO Bruksel, me lëndë: "Dërgohet dokumenti i klasifikuar 'The espionage activity against the Albanian Armed Forces by the Russian Military Representatives in Albania'", niveli "Sekret".

77. Shkresa nr. 190, datë 17.5.2007 e DSIK-së drejtuar SHISH-it, me lëndë: "Mbi Autoritetin Kombëtar të Sigurimit të Komunikimeve dhe Autoritetin Kombëtar të Shpërndarjes", niveli "I kufizuar".

78. Shkresa e DSIK-së nr. 196/1, datë 11.6.2007 e DSIK-së drejtuar ambasadorit të Republikës së Shqipërisë në NATO Bruksel, me lëndë: "Dërgohet dokumenti i klasifikuar Russian, Serbs and Iranian inteligence service activity in Albania", niveli "Sekret".

79. Shkresa nr. 207, datë 24.9.2007 e DSIK-së drejtuar SHISH-it, me lëndë: "Dërgohet certifikata e sigurisë së PGP", niveli "Tepër sekret".

80. Shkresa nr. 209, datë 28.9.2007 e DSIK-së drejtuar SHISH-it, me lëndë: "Kërkohet verifikimi i pastërtisë së figurës një aplikanti", niveli "Konfidencial".

81. Vendim nr. 3, datë 12.11.2007 i SHISH-it "Për zhvlerësim dokumentesh arkivore", niveli "Sekret".

82. Shkresa nr. 225, datë 5.12.2007 e DSIK-së drejtuar SHISH-it, me lëndë: "Kërkohet verifikimi i pastërtisë së figurës për një aplikant", niveli "Konfidencial".

83. Shkresa nr. 230, datë 12.12.2007 e DSIK-së drejtuar ambasadorit të Republikës së Shqipërisë NATO, Bruksel, me lëndë: "Konfirmim për marrjen e informacioneve të klasifikuar të NATO-s", niveli "I kufizuar".

84. Shkresa nr. 231, datë 12.12.2007 e DSIK-së drejtuar ambasadorit të Republikës së Shqipërisë në NATO Bruksel, me lëndë: "Për zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 8922 datë 22.7.2002 "Për ratifikimin e 'Marrëveshjes për sigurimin e informacionit të klasifikuar 'Sekret shtetëror' ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe NATO-s'", si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore", niveli "I kufizuar".

85. Shkresa nr. 232, datë 13.12.2007 e DSIK-së drejtuar SHISH-it, me lëndë: "Kërkohet verifikimi i pastërtisë së figurës për një aplikant", niveli "Konfidencial".

86. Shkresa nr. 233, datë 14.12.2007 e DSIK-së drejtuar SHISH-it, me lëndë: "Kërkohet verifikimi i pastërtisë së figurës për një aplikant", niveli "Konfidencial".

87. Shkresa nr. 233/1, datë 14.12.2007 e DSIK-së drejtuar drejtorit të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, me lëndë: "Kërkohet verifikimi i pastërtisë së figurës për një aplikant", niveli "Konfidencial".

88. Shkresa nr. 234, datë 14.12.2007 e DSIK-së drejtuar SHISH-it, me lëndë: "Kërkohet verifikimi i pastërtisë për një aplikant", niveli "Konfidencial".

89. Shkresa nr. 234/1, datë 14.12.2007 e DSIK-së drejtuar drejtorit të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, me lëndë: "Kërkohet verifikimi i pastërtisë së figurës për një aplikant", niveli "Konfidencial".

90. Shkresa nr. 235/1, datë 14.12.2007 e DSIK-së drejtuar SHISH-it, me lëndë: "Kërkohet verifikimi i pastërtisë së figurës për një aplikant", niveli "Konfidencial".

91. Shkresa nr. 235, datë 14.12.2007 e DSIK-së drejtuar SHISH-it, me lëndë: "Kërkohet verifikimi i pastërtisë për një aplikant", niveli "Konfidencial".

92. Shkresa nr. 236/1, datë 14.12.2007 e DSIK-së drejtuar SHISH-it, me lëndë: "Kërkohet verifikimi i pastërtisë së figurës për një aplikant", niveli "Konfidencial".

93. Shkresa nr. 236, datë 14.12.2007 e DSIK-së drejtuar SHISH-it, me lëndë: "Kërkohet verifikimi i pastërtisë së figurës për një aplikant", niveli "Konfidencial".

94. Shkresa nr. 564/3 datë 24.12.2007 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Për pajisjen me certifikatë sigurie për një aplikant", niveli "Konfidencial".

95. Shkresa nr. 578/3, datë 24.12.2007 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Për pajisjen me certifikatë sigurie për një aplikant", niveli "Konfidencial".

96. Shkresa nr. 241, datë 21.12.2007 e DSIK-së drejtuar Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, me lëndë: "Dërgohet një përmbledhje e Raportit të Inspektimit të Zyrës së Sigurisë së NATO-s

(NOS)", niveli "I kufizuar".

97. Shkresa nr. 241/1, datë 21.12.2007 e DSIK-së drejtuar Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, me lëndë: "Dërgohet dokumenti i klasifikuar i NATO-s Report by the NOS on the Unspection of the Protection of Relased Classified NATO Informacion in Albania, October 2007", niveli "I kufizuar".

98. Shkresa nr. 242, datë 21.12.2007 e DSIK-së drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë, me lëndë: "Dërgohet një përmbledhje e Raportit të Inspektimit të Zyrës së Sigurisë së NATO-s (NOS)", niveli "I kufizuar".

99. Shkresa nr. 242/1 datë 21.12.2007 e DSIK-së drejtuar Presidentit të Republikës, me lëndë: "Dërgohet dokumenti i klasifikuar i NATO-s the inspection of the security arrangements for the protection of released classified NATO information in Albania, Oktober 2007".

100. Shkresa nr. 243, datë 24.12.2007 e DSIK-së drejtuar SHISH-it, me lëndë: "Kërkohet verifikimi i pastërtisë për një aplikant", niveli "Konfidencial".

101. Shkresa nr. 553/3, datë 14.12.2007 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Për pajisjen me certifikatë sigurie për një aplikant", niveli "Konfidencial".

102. Shkresa nr. 554/3, datë 14.12.2007 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Për pajisjen me certifikatë sigurie për një aplikant", niveli "Konfidencial".

103. Shkresa nr. 552/3, datë 14.12.2007 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë "Për pajisjen me certifikatë sigurie për një aplikant", niveli "Konfidencial".

104. Shkresa nr. 556/3, datë 14.12.2007 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Për pajisjen me certifikatë sigurie për një aplikant", niveli "Konfidencial".

105. Shkresa nr. 555/3, datë 14.12.2007 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Për pajisjen me certifikatë sigurie për një aplikant", niveli "Konfidencial".

106. Shkresa nr. 557/3, datë 14.12.2007 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Për pajisjen me certifikatë sigurie për një aplikant", niveli "Konfidencial".

107. Shkresa nr. 8/4, datë 26.12.2007 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Dërgohet vendimi i KDZH për zhvlerësim dokumentash dhe bibliografia e dokumenteve të zhvlerësuara", niveli "Sekret".

108. Shkresa nr. 543/3, datë 13.12.2007 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Për pajisjen me certifikatë sigurie për një aplikant", niveli "Konfidencial".

109. Shkresa nr. 546/3, datë 13.12.2007 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Për pajisjen me certifikatë sigurie për një aplikant", niveli "Konfidencial".

110. Shkresa nr. 547/3, datë 13.12.2007 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Për pajisjen me certifikatë sigurie për një aplikant", niveli "Konfidencial".

111. Shkresa nr. 548/4, datë 13.12.2007 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Për pajisjen me certifikatë sigurie për një aplikant", niveli "Konfidencial".

112. Shkresa nr. 549/3, datë 13.12.2007 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Për pajisjen me certifikatë sigurie për një aplikant", niveli "Konfidencial".

113. Shkresa nr. 550/3, datë 13.12.2007 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Për pajisjen me certifikatë sigurie për një aplikant", niveli "Konfidencial".

114. Shkresa nr. 541/3, datë 14.12.2007 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Për pajisjen me certifikatë sigurie për një aplikant", niveli "Konfidencial".

115. Shkresa nr. 540/3, datë 14.12.2007 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Për pajisjen me certifikatë sigurie për një aplikant", niveli "Konfidencial".

116. Shkresa nr. 539/3, datë 14.12.2007 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Për pajisjen me certifikatë sigurie për një aplikant", niveli "Konfidencial".

117. Shkresa nr. 542/3, datë 14.12.2007 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Për pajisjen me certifikatë sigurie për një aplikant", niveli "Konfidencial".

118. Shkresa nr. 545/3, datë 14.12.2007 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Për pajisjen me certifikatë sigurie për një aplikant", niveli "Konfidencial".

119. Shkresa nr. 544/3, datë 14.12.2007 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Për pajisjen me certifikatë sigurie për një aplikant", niveli "Konfidencial".

120. Shkresa nr. 551/3, datë 14.12.2007 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Për pajisjen me certifikatë sigurie për një aplikant", niveli "Konfidencial".

121. Shkresa nr. 558/3, datë 14.12.2007 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Për pajisjen me certifikatë sigurie për një aplikant", niveli "Konfidencial".

122. Shkresa nr. 559/3, datë 13.12.2007 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Për pajisjen me certifikatë sigurie për një aplikant", niveli "Konfidencial".

123. Shkresa nr. 560/3, datë 14.12.2007 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Për pajisjen me certifikatë sigurie për një aplikant", niveli "Konfidencial".

124. Shkresa nr. 561/3, datë 14.12.2007 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Për pajisjen me certifikatë sigurie për një aplikant", niveli "Konfidencial".

125. Shkresa nr. 562/3, datë 13.12.2007 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Për pajisjen me certifikatë sigurie për një aplikant", niveli "Konfidencial".

126. Shkresa nr. 563/3, datë 13.12.2007 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Për pajisjen me certifikatë sigurie për një aplikant", niveli "Konfidencial".

127. Shkresa nr. 565/3, datë 13.12.2007 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Për pajisjen me certifikatë sigurie për një aplikant", niveli "Konfidencial".

128. Shkresa nr. 566/3, datë 13.12.2007 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Për pajisjen me certifikatë sigurie për një aplikant", niveli "Konfidencial".

129. Shkresa nr. 567/3, datë 13.12.2007 e SHISH-it drejtuar DSIK-së, me lëndë: "Për pajisjen me certifikatë sigurie për një aplikant", niveli "Konfidencial".

130. Shkresa nr. 8/3 datë 23.12.2007 e SHISH-it "Bibliografia e informacionit të zhvlerësuar".

131. Shkresa nr. 276, datë 27.12.2007 e DSIK-së drejtuar SHISH-it, me lëndë: "Kërkohet verifikimi i pastërtisë së figurës për një aplikant", niveli "Konfidencial".

Publikimi i Bibliografisë bëhet në Fletoren Zyrtare dhe në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK).

DREJTORI
Dorian Tola

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 280 lekë